

LIGJ
Nr. 9/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN
PËR PROGRAMIN IPA TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I
ZI-SHQIPËRI 2021–2027

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 84, datë 26.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE FINANCIMI

KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim referuar si “Komisioni”, i cili vepron për llogari dhe në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si “BE”, në njërën anë;

dhe

Mali i Zi, i përfaqësuar nga qeveria e Malit të Zi (në vijim referuar si “Mali i Zi”);

dhe

Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave (në vijim referuar si “Shqipëria”), në vijim referuar bashkërisht si “Përfituesit e IPA III”, ose veçmas referuar si “përfitues/e i/e IPA III”, në anën tjetër,

dhe së bashku e bashkërisht, referuar si “palët”;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar (BNK)

1. BE-ja bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA III bien dakord që të pranojnë financimin e Programit të mëposhtëm të BNK-së, siç përshkruhet në shtojcën I:

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi–Republika e Shqipërisë për periudhën 2021–2027.

Numrat e angazhimit global:

Për vitin 2022: JAD.976622

Ky Program i BNK-së financohet nga buxheti i BE-së në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)¹.

2. Kostoja totale e vlerësuar e këtij Programi të BNK-së është 13 790 000 euro dhe kontributi maksimal i BE-së në këtë Program të BNK-së është përcaktuar të jetë 11 900 000 euro.

Kontributi i BE-së do të ndahet në angazhime vjetore për periudhën 2022, 2025 dhe 2027 në përputhje me shtojcën I. Asnjë element në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet sikur nënkupton një angazhim financiar të BE-së në lidhje me kreditë, të cilat ende nuk kanë marrë miratimin nga buxheti i aprovuar i BE-së. Miratimi i angazhimeve vjetore të mëvonshme, të përcaktuara në shtojcën I, do të aprovohet përmes shkëmbimit të shkresave midis Komisionit dhe përfituesve të IPA III.

Nga përfituesit e IPA III nuk kërkohet asnjë kontribut financiar.

3. Programi i BNK-së do të zbatohet në përputhje me përshkrimin e dhënë në shtojcën I.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 1, të shtojcës II, është përcaktuar të jetë 12 vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit, ose nga shkëmbimi i shkresave për kështet e mëvonshme të buxhetit.

2. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 2, të shtojcës II, është përcaktuar të jetë 6 vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit, ose nga shkëmbimi i shkresave për kështet e mëvonshme të buxhetit.

3. Këto periudha mund të zgjaten siç parashikohet në nenin 15, të shtojcës II.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi do të bëhen me shkrim, do t'i referohen shprehimisht Programit të BNK-së, siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 1 dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin:

Znj. Michela Matuella

Drejtoreshë në detyrë (Drejtorja NEAR. D), për Ballkanin Perëndimor

Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR)

Rue de la Loi 15

Komisioni Evropian

B-1049 Bruksel, Belgjikë

email: NEAR-D@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA III

Për Malin e Zi:

Ministria e Punëve për Evropën

Bulevar Revolucion 15

¹ Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 shtator 2021, “Për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Gazeta Zyrtare L 330, 20.9.2021, f. 1.

81000 Podgoricë, Mal i Zi
email: kabinet@mep.gov.me

Për Shqipërinë:

Z. Ilir Beqaj
Koordinator Kombëtar i IPA-s (KKIPA)
Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 1
1001 Tiranë, Shqipëri
email: eufa@saspac.gov.al

Neni 4

Pika e kontaktit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtimit (ZEKM)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA III që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me Zyrën Evropiane Kundër Mashtimit (ZEKM), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të ZEKM-së do të jetë:

Për Malin e Zi:

Znj. Nataša Kovačević
Pikë kontakti për SHKKM-në/zyra e SHKKM-së
Ministria e Financave
Stanka Dragoj evića 2
81000 Podgoricë, Mal i Zi
email: natasa.kovacevic@mif.gov.me

Për Shqipërinë:

Znj. Blerina Naska
Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Financiar, Inspektimi Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 3
1001 Tiranë, Shqipëri
email: blerina.naska@financa.gov.al

Neni 5

Marrëveshjet Financiare Kuadër të Partneritetit

Programi i BNK-së do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit (MFKP), përkatësisht ndërmjet Komisionit Evropian dhe Malit të Zi për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Malin e Zi, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), dhe në përputhje me dispozitat e MFKP-së mes Komisionit Evropian dhe Shqipërisë, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III) (referuar në vijim si “MFKP-të”).

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e MFKP-ve të sipërpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe, nga ana tjetër, e dispozitave të MFKP-së përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Sipas nenit 154, paragrafi 5, të Rregullores Financiare, zbatimi i programit nën menaxhimin e tërthortë të përfituesit të IPA-s do të plotësohet me masat e posaçme të paraqitura në nenin 7.

Neni 6

Shtojcat

1. Kjo Marrëveshjeje Financimi është e përbërë nga:
 - a) Këto Kushte të Veçanta;
 - b) Shtojca I: Programi i BNK-së Mali i Zi–Republika e Shqipërisë për periudhën, 2021–2027;
 - c) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
 - d) Shtojca III: Modeli i raportit vjetor të BNK-së për zbatimin e asistencës nga IPA III në përputhje me nenin 80 të MFKP-së;
 - e) Shtojca IV, modeli i raportit financiar sipas nenit 61, paragrafi 2, germa “a” dhe 61, paragrafi 3, të MFKP-së, duke përfshirë modelin e parashikimeve për kërkesat e pagesave të mundshme sipas nenit 33, paragrafi 3, të MFKP-së;
 - f) Shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara.
2. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe dispozitave të shtojcës II, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 7

Dispozita që derogojnë nga shtojca II apo që e plotësojnë atë

Në bazë të misionit verifikues për delegimin e detyrave të zbatimit të buxhetit, i cili u realizua në qershor të vitit 2023, do të zbatohen masat e mëposhtme të posaçme:

- DG NEAR do të kryejë një mision vijues verifikimi menjëherë pas krijimit të sistemeve të IPA III;

- Strukturave dhe autoriteteve kombëtare u ndalohet të hyjnë në angazhime të reja ligjore, duke përfshirë vendimet e shpalljes së fituesve, pa dalë më parë rezultati i kënaqshëm i misionit vijues të verifikimit;

- Transferimi i fondeve nga DG NEAR te përfituesit e IPA III do të pezullohen pa dalë më parë rezultati i kënaqshëm i misionit vijues të verifikimit.

Paragrafi në vijim plotëson shtojcën II:

Komisioni synon të prezantojë, në mënyrë progresive, një sistem shkëmbimi elektronik për raportimin e kontratave nën menaxhimin e tërthortë të përfituesit të IPA III (“Aplikacioni IPA”). Përfituesi i IPA III do të duhet të regjistrohet dhe të përdorë aplikimin IPA për të mundësuar menaxhimin elektronik të Marrëveshjeve të Financimit.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi konsiderohet e nënshkruar në datën që nënshkruhet nga pala e fundit, dhe jo më vonë se data 31 dhjetor 2023.

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi në datën kur Komisioni merr një njoftim nga përfituesit e IPA III, i cili konfirmon realizimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA III, që cilësohen të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni do të informojë përfituesit e IPA III për datën e marrjes së këtij njoftimi. Njoftimi i fundit nga dy njoftimet e marra nga përfituesit e IPA III do të merret në konsideratë për hyrjen në fuqi.

Pjesa e programit e zbatuar nën menaxhim të tërthortë me përfituesit e IPA III, me përjashtim të hapjes së procedurave për shpalljen e fituesit, do të nisë vetëm pasi të ketë hyrë në fuqi MFKP-ja dhe pasi të ketë përfunduar delegimi i nevojshëm i detyrave për zbatimin e buxhetit.

Kjo marrëveshje është hartuar në tri kopje në gjuhën angleze, një i dorëzohet Komisionit dhe një për secilin prej përfituesve të IPA III.

PËR PËRFITUESIT E IPA III

PËR KOMISIONIN

Për Malin e Zi:

Qeveria e Malit të Zi

Për Komisionin:

Znj. Michela Matuella

Drejtoreshë në detyrë (Drejtoria NEAR. D), për Ballkanin

Perëndimor Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë

dhe Negociatat e Zgjerimit, Komisioni Evropian

Podgoricë, më

Data:

Nënshkrimi:

Bruksel, më

Data:

Nënshkrimi:

Për Shqipërinë:

Z. Ilir Beqaj

Koordinator Kombëtar i IPA-s (KKIPA)

Tiranë, më

Data:

Nënshkrimi

**SHQIP
ANEKS**

I VENDIMIT ZBATUES TË KOMISIONIT PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT TË
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI-REPUBLIKA E SHQIPËRISË, PËR
PERIUDHËN 2021-2027

DOKUMENTI I VEPRIMIT PËR: PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI
I ZI-REPUBLIKA E SHQIPËRISË, PËR PERIUDHËN 2021-2027

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhja e programit

Qëllimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm

Qëllimi 8. Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe elastike, punësimi i plotë dhe produktiv dhe sigurimi i punës së denjë për të gjithë

Qëllimi 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë të gjithë jetës për të gjithë

Qëllimi 10. Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve

Qëllimi 11. Transformimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme

Qëllimi 13. Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre

Qëllimi 15. Mbrojtja, rikuperimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, lufta kundër shkretëtirizimit dhe ndalimi i degradimit të tokës dhe i humbjes së biodiversitetit

Lista e akronimeve

1. Përmbledhje e programit

1.1 Përmbledhje e programit

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

2. Zona e programit

Gjeografia

Demografia

Migrimi dhe dendësia

Varfëria

Sektori privat
 Bujqësia dhe zhvillimi rural
 Turizmi
 Mjedisit dhe natyra
 Infrastruktura
 Rrugët
 Transporti hekurudhor
 Transporti ajror dhe detar
 Telekomunikacioni, teknologjitë e informacionit
 Energjia
 Aspekti social
 Arsimit dhe rinia
 Kërkimi shkencor, TIK dhe inovacioni
 Shëndeti
 Kultura
 Shogëria civile
 2.2 Gjetjet kryesore
 3. Strategjia e Programit
 3.1 Arsyetimi – Arsyetimi për strategjinë e përzgjedhur të ndërhyrjes
 3.2 Përsëkrimi i prioritetëve të programit
 3.3 Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale
 3.4 Kohëzotimi me programet e tjera dhe me strategjitë makro-rajonale
 3.5 Kushtet dhe supozimet
 4. Buxheti indikativ
 5. Marrëveshjet e zbatimit
 5.1 Marrëveshja financiare
 5.2 Periudha treguese e zbatimit
 5.3 Metodat e zbatimit
 5.4 Struktura e menaxhimit të programit
 5.5 Zhvillimi, përzgjedhja dhe zbatimi i projektit
 5.6 Fusha e përshtatshmërisë gjeografike për prokurime dhe grante
 6. Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi
 7. Informacioni dhe vizibiliteti
 8. Qëndrueshmëria

PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

Akti themelor	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III)
Titulli i programit	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Republika e Shqipërisë për 2021-2027
Numri OPSYS	ACT-60806 2022 JAD.976622 2025 JAD.976628 2027 JAD.976631
Dokument programimi	Korniza e Programimit IPA III
Dritarja	Dritarja 5 Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar
Zona e programit	Mali i Zi: - Andrijevice, Berane, Plavë, Petnjica, Rožaje, Podgoricë, Cetinjë, Danilovgrad, Budva, Ulqin, Tivar, Gusinje, Tuz, Kolashin Shqipëri: - Qarqet Shkodër dhe Lezhë - Bashkia Tropojë
Objektivi/ndikimi i përgjithshëm i programit	Promovimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, nxitja e integritetit në Bashkimin Evropian dhe kontribimi në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së

	popullsisë në zonën ndërkufitare të programit nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin
Grupimet tematike të programit (KT), prioritetet tematike (PT) dhe objektivat/rezultatet specifike (OS) për çdo prioritet tematik	PT0: Asistencë Teknike OS1: Sigurimi i zbatimit eficient, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për programin mes komuniteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe, në përgjithësi, popullatës në zonën që plotëson kushtet për të përfutur nga ky program. Grupimi tematik 2: Eficiencë më e gjelbër dhe e përmirësuar i burimeve
	PT2: Mbrojtja e mjedisit, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut OS1: Bërja e territorit ndërkufitar më të qëndrueshëm sa i përket mjedisit dhe më elastik
	Grupimi tematik 4: Përmirësimi i klimës së biznesit dhe
	<u>Konkurrueshmërisë</u> PT5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore 501: Ofrimi i një kontributi më të madh nga turizmi ndërkufitar dhe trashëgimia kulturore/natyrore në zhvillimin ekonomik ndërkufitar 502: Përmirësimi i konkurrencës së ofruesve të shërbimeve/NVM-ve në sektorin e turizmit Shënim: Grupimi tematik KT 5: Integrimi i një kapaciteti më të mirë të autoriteteve lokale dhe rajonale për adresimin e sfidave lokale. Propozimi i përfutur për integrimin e këtij Grupimi tematik është paraqitur në seksionin 3.3 të këtij dokumenti.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të)	<i>OZHQ kryesore:</i> Objektivi 8. Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe elastike, punësimi i plotë dhe produktiv dhe sigurimi i punës së denjë për të gjithë Në kuadër të zbatimit të programit 7-vjeçar të bashkëpunimit ndërkufitar, operacionet e përzgjedhura do të kontribuojnë edhe në OZHQ-të e mëposhtme Objektivi 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë Objektivi 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave Objektivi 10. Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve të ndryshme Objektivi 11. Transformimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme Objektivi 13. Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre Objektivi 15. Mbrojtja, rikuperimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, lufta kundër shkretëtirimit dhe ndalimi i degradimit të tokës dhe i humbjes së biodiversitetit
Kodi(et) DAC ²	15110 – Politika e sektorit publik dhe menaxhimi administrativ – 10%; 33210 – Politika e turizmit dhe menaxhimi administrativ – 45%; 410 – Mbrojtja e Përgjithshme e Mjedisit – 25%; 43060 - Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë – 10%; 74020 - Gatishmëria për të reaguar ndaj disa rreziqeve njëherësh - 10%.
INFORMACION PËR BUXHETIN	
Zërat buxhetorë	15.020300
Kostoja totale 2021-2027	13 790 000 euro
Kontributi total i BE-së 2021-2027	11 900 000 euro
Kontributi vjetor i BE-së	Për vitin 2022 – EUR 3400 000; Për vitin 2025 – EUR 5100 000; Për vitin 2027 – EUR 3400 000. Në varësi të disponueshmërisë së ndarjeve buxhetore për vitet përkatëse financiare pas miratimit të buxhetit vjetor përkatës, ose siç parashikohet në sistemin e një të dymbëdhjetës së përkohshme.
MENAXHIMI DHE ZBATIMI	
Metoda e zbatimit	<i>Për operacionet:</i> Menaxhimi indirekt nga Mali i Zi <i>Për Asistencën Teknike</i> Menaxhimi i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian

Strukturat përgjegjëse të BNK-së/autoritetet përkatëse të	Në Malin e Zi: - Qeveria e Malit të Zi, Zyra e Integritetit Evropian (Autoriteti Menaxhues) - Ministria e Financave dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Financës dhe Kontraktimi i Fondeve të Asistencës së BE-së (organ i ndërmjetëm për menaxhimin financiar).
---	--

² Sektorët e DAC (kodet dhe përshkrimet) paraqiten në kolonën e parë dhe të katërt të skedës 'kodet e qëllimit' në dokumentin vijues: <http://www.oecd.org/dac/financing-sustainable-development/development-financestandards/dacandercodelists.htm>

vendeve pjesëmarrëse të IPA III ³	Në Shqipëri: - Qeveria e Shqipërisë, Koordinator i Kombëtar i IPA-s (NIPAC) dhe Struktura BNK e krijuar sipas kuadrit ligjor IPA III.
SPT/Zyrat e Antenave të Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT)	Zyra kryesore e SPT-së: Podgoricë, Mali i Zi Zyra e Antenës: Shkodër, Shqipëri
Data përfundimtare për lidhjen e Marrëveshjes Financiare	Për angazhimin buxhetor të vitit 2022 maksimumi brenda 31 dhjetorit N+1.
Data përfundimtare për marrëveshjen (shkëmbimin e letrave) mes të gjitha palëve për alokimet e mëtejshme buxhetore vjetore për zbatimin e Marrëveshjes Financiare	Për angazhimin buxhetor të vitit 2025 maksimumi brenda 31 dhjetorit N+1; Për angazhimin buxhetor të vitit 2027 maksimumi brenda 31 dhjetorit N+1.
Data përfundimtare për lidhjen e kontratave të prokurimit dhe grantit	3 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes Financiare (ose shkëmbimit të letrave për kështet buxhetore pasuese) me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 114 të FR.
Periodha indikative e zbatimit operacional	6 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes Financiare (ose shkëmbimit të letrave për kështet buxhetore).
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes Financiare	12 vjet pas përfundimit të Marrëveshjes Financiare (ose shkëmbimit të letrave për kështet e mëvonshme buxhetore).

Lista e shkurtimeve

AL	Shqipëria (<i>Albania</i>)
AK	Autoriteti Kontraktues
BNK	Bashkëpunimi ndërkufitar
Forumi BNK	Forumi konsultativ rajonal BNK
CBIB+3	Ndërtimi i institucioneve ndërkufitare plus Faza III
NJQFK	Njësia qendrore e financave dhe kontraktimit
CfP-të	Thirrjet për propozime
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
DEU	Delegacioni i Bashkimit Evropian
ZIE	Zyra e Integritetit Evropian, Mali i Zi
BE	Bashkimi Evropian
EUSAIR	Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jon
EUSDR	Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
IPA	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural
KPM	Komiteti i Përbashkët Monitorues
TFP	Task-Forca e Përbashkët
SPT	Sekretariati i Përbashkët Teknik
ME	Mali i Zi
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shqipëri
MONSTAT	Enti Statistikor i Malit të Zi
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OS	Struktura e BNK-së (nëse teksti i referohet IPA II, nënkupton Strukturën Operuese)
PESTLE	Politike, ekonomike, sociale, teknologjike, juridike, mjedisore
KBR	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
NMVM	Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
OS	Objektivi/rezultati specifik
SWOT	Përparësitë, dobësitë, mundësitë, kërcënimet
AT	Asistencë teknike
KT	Grupim tematik
PT	Prioritet tematik
BB	Ballkani Perëndimor

1. Përmbledhje e programit

Programi IPA III i bashkëpunimit ndërkufitar 2021–2027 midis Malit të Zi (ME) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) me synim promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, nxitjen e integritetit në Bashkimin Evropian, si dhe zhvillimin social-ekonomik nëpërmjet nismave të përbashkëta lokale dhe rajonale.

Dispozitat ligjore për zbatimin e programit përcaktohen në legjislacionin e mëposhtëm të BE-

³ Strukturat dhe përgjegjësitë përkatëse do të përcaktohen në përputhje me kuadrin legjislativ për IPA III, me Marrëveshjen korresponduese të partneritetit kuadër dhe me Marrëveshjen Financiare

së: Rregullorja (BE) 2021/1529, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021, për ngritjen e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III).

1.1 Përmbledhje e programit

Analiza e detajuar e situatës socio-ekonomike e bashkive dhe e rajoneve të përfshira në zonën e programit na jep një tablo të realitetit në terren, bazuar në të dhënat statistikore të disponueshme, raportet, strategjitë kombëtare, rajonale dhe bashkiake.

Zona e programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA III mes Malit të Zi dhe Shqipërisë mbulon një territor prej 12,781 km², duke zënë një sipërfaqe pak më të madhe në Malin e Zi, që përbën rreth 52% të të gjithë vendit krahasuar me 48% të sipërfaqes së Shqipërisë. Popullsia që jeton në zonën e këtij programi është 754.190 banorë dhe përbën rreth 64,91% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi dhe 12,31% të popullsisë së Shqipërisë. Në total, zona e programit përfshin 23 komuna dhe gjithsej 1305 vendbanime, duke përfshirë shumë qytete dhe fshatra. Nëntë prej komunave që mbulon ky program ndodhen drejtpërdrejt në kufi. Gjatësia e vijës kufitare është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufij ujorë të përbërë nga liqeni i Shkodrës, deti Adriatik dhe një sërë lumenjsh. Zona e programit e të dyja vendeve ka përjetuar flukse të brendshme migrimi. Vitet e fundit, në zonën e programit ka ndodhur një lëvizje e popullsisë drejt rajoneve qendrore dhe bregdetare, të cilat janë gjerësisht më të zhvilluara dhe ofrojnë më shumë mundësi socio-ekonomike, si dhe nga qendrat rurale në ato urbane. Emigrantët e brendshëm vendosen në qytete në kërkim të punësimit, veçanërisht në sektorët e turizmit dhe ndërtimit. Kontrastet e elementeve gjeografikë të kësaj zone e pasurojnë mjedisin, florën dhe faunën e zonës së programit. Burimet e tij natyrore janë tërheqëse për zhvillimin e turizmit dhe të bujqësisë së qëndrueshme dhe mund të jenë shtytësit kryesorë ekonomikë drejt rritjes së prosperitetit të zonës së programit. Për shkak të vlerës së tyre mjedisore, zona e BNK-së është strehëz për disa zona të mbrojtura, rezerva natyrore dhe parqe kombëtare.

Bazuar në një raund konsultimesh me disa organizata dhe institucione, një sërë autoritetesh lokale kërkuan dhe theksuan rëndësinë e përfshirjes së komunës së Kolashinit në zonën e programit. Kjo u mbështet njëzëri nga anëtarët e Task-Forcës së Përbashkët. Gjithashtu, krahas prioriteteve tematike të përzgjedhura dhe objektivave/rezultateve specifike të programit, vihet re se integrimi gjinor mbetet një pjesë e rëndësishme horizontale e këtij programi. Qëllimi i tij është të sigurojë që ky program BNK-je të maksimizojë përfitimet e tij për të gjithë dhe të kontribuojë në adresimin e çështjeve të pabarazisë.

Zona e programit është e larmishme, por megjithatë ka një sërë karakteristikash të përbashkëta, si: gjeografia, tendencat demografike - popullsia e re në moshë, zhvillimi ekonomik, potenciali turistik, asetet mjedisore dhe antropogjene, shpirti sipërmarrës dhe angazhimet e ndërmarra drejt rritjes së konkurrencës, inovacionit dhe aftësive; të gjitha këto përfaqësojnë mundësi për iniciativë BNK. Në këtë kontekst, gjetjet dhe nevojat kryesore të zonës së programit përfshijnë veçoritë ekonomike, si investimet në turizëm, energjitë e rinovueshme dhe bujqësinë. Edhe çështja e mbrojtjes së mjedisit ka nevojë për shqyrtim serioz në planet e ardhshme zhvillimore të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit që mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për biodiversitetin e zonës. Zona e programit ka gjithashtu një potencial të lartë turistik dhe kështu duhet të merren parasysh iniciativat e BNK-së që synojnë të prodhojnë një ofertë të përbashkët turistike. Për më tepër, ka një sërë sinergjish, të cilat potencialisht mund të mbështeten nga programi BNK. Në zonën e programit ka një trashëgimi të pasur historiko-kulturore-artistiko-fetare e cila duhet të ruhet. Përveç kësaj, shumë më tepër vlerë mund të ketë trashëgimia e saj historike dhe kulturore. Nga ana tjetër, edhe sinergjitë me turizmin fetar mund të kontribuojnë në forcimin e identitetit të zonës. Konkurrueshmëria si temë kërkon gjithashtu vëmendje pasi është ende në zhvillim në të dyja anët e kufirit duke pasur parasysh se të dyja vendet kanë një interes të shtuar për të investuar në të. Qeveritë lokale dhe rajonale kërkojnë gjithashtu veprime për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që të absorbojnë më mirë projektet e financuara nga BE-ja. Mund të përmirësohet edhe bashkëpunimi ndërmjet qeverive lokale dhe rajonale

ndërmjet të dyja vendeve.

Çështjet kryesore të theksuara nga analiza socio-ekonomike e lartpërmendur u konfirmuan dhe u plotësuan përmes konsultimeve të gjera me një gamë të gjerë palësh të interesuara në nivel kombëtar, rajonal dhe komunal, si me intervista ballë për ballë ashtu edhe me një pyetësor të strukturuar (të ofruar nga projekti CBIB+) që mundësoi mbledhjen e pikëpamjeve mbi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT), si dhe analizimin se cilat ishin prioritetet kryesore për rajonin.

Në këtë kontekst, dhe bazuar në situatën dhe analizat SWOT, duke përfshirë një sërë aspektesh politike, ekonomike, sociale, teknologjike, ligjore dhe mjedisore (PESTLE), mbi situatën aktuale në të dyja vendet dhe veçanërisht në zonën e programit, Task-Forca e Përbashkët (TFP) që mbikëqyr zbatimin e këtij programi zgjodhi grupet tematike/prioritetet tematike të mëposhtme:

Grupimi tematik 2: Sigurimi i një efikasiteti më të gjelbër dhe më të mirë të burimeve

TP2: Bërja e territorit ndërkufitar më të qëndrueshëm dhe më elastik në aspektin ekologjik.

Fushat kryesore të ndërhyrjes në këtë kontekst theksojnë se zona e programit është e pasur me burime mjedisore dhe ka një diversitet të lartë biologjik që përfshin male, kodra, fusha, vijë bregdetare, parqe natyrore, liqene dhe lumenj. Ruajtja e mjedisit dhe mbrojtja e këtyre burimeve janë shtylla të të gjitha strategjive të zhvillimit në të dyja vendet dhe konsiderohen si prioritet i lartë nga të dyja qeveritë.

Grupimi tematik 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë

PT5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.

Zona e programit karakterizohet nga një potencial i lartë turistik, por mundësi të tilla ekonomike duhet ende të zhvillohen, duke rritur vëmendjen dhe fokusin si nga politikëbërësit kombëtarë, ashtu edhe ata vendorë. Zona e programit është gjithashtu e pasur me tradita të larmishme të kulinarisë dhe zejeve që luajnë rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e turizmit. Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet institucioneve kulturore është tashmë i pranishëm, por kjo mund të intensifikohet më tej.

Zona e programit ka shumë subjekte biznesi të dominuara nga NMVM-të, të cilat luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e saj ekonomik. Megjithatë, konkurrenca kërkon vëmendjen e duhur pasi është ende e dobët në të dyja anët e kufirit. Produktiviteti më i lartë dhe investimi i mëtejshëm në njohjen dhe në përdorimin e teknologjive inovative janë parakushte për t'u bërë më konkurrues, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Me përfshirjen horizontale të autoriteteve publike në të gjitha/shumicën e operacioneve (bazuar në kapacitetet e tyre juridike), kapacitetet e tyre do të forcohen dhe do të fuqizohen për të luajtur një rol aktiv në mbështetjen e sa më sipër.

Dizajni i programit është mbështetur gjithashtu në përvojën e zbatimit të dy programeve të mëparshme, në ciklet financiare 2007–2013 dhe 2014–2020, si dhe nga programe të tjera BNK dhe programe transnacionale ku marrin pjesë të dyja vendet. Gjithashtu, ai konsideron si relevante edhe ndërhyrjet e tjera që po ndodhin ose që planifikohen të ndërmerren në zonën e programit.

Mbështetja që do të jepet në kuadër të këtij plani veprimi shumëvjeçar do të kontribuojë drejtpërdrejt dhe do të krijojë sinergji me prioritetet e Planit Ekonomik dhe të Investimeve⁴ dhe me Axhendën e Gjelbër⁵ për Ballkanin Perëndimor.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Programi IPA III BNK 2021–2027, midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, është rezultat i punës së përbashkët programuese, të kryer nga strukturat operative (SO) të vendeve pjesëmarrëse në koordinim me përfaqësues nga institucionet qendrore përkatëse, institucionet lokale të zonës së programit dhe organizatat lokale dhe me mbështetjen e projektit CBIB+3 dhe në koordinim të ngushtë me DG NEAR dhe DEU-t përkatëse. Një TFP është krijuar me të gjithë këta anëtarë nga të dyja vendet për të përgatitur këtë dokument programi nën udhëheqjen e SO-ve dhe me mbështetjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT). Qëllimi i SPT-së është të përgatisë planifikimin dhe programimin strategjik të IPA III BNK 2021–2027. Ai përbëhet nga ministritë e

⁴ COM(2020) 641, 6.10.2020.

⁵ SWD(2020) 223, 6.10.2020.

linjës së të dyja vendeve, këshillat e rajoneve nga zonat e pranueshme dhe nga anëtarë të bashkive dhe përfaqësues të OSHC-ve. Gjithashtu janë mbledhur dhe janë analizuar burimet dytësore, duke përfshirë edhe statistikën në nivelet e BE-së, statistika kombëtare, rajonale dhe lokale. Studimet, vlerësimet, dokumentet strategjike dhe planet ekzistuese të veprimit në nivele sektoriale dhe territoriale dhe raportet mbi zbatimin e programit IPA II janë analizuar dhe informacioni përkatës është përfshirë në Analizën e Situatës.

Procesi i programimit është zhvilluar nga fundi i prillit 2020 deri në korrik 2021. Më pas, programi është hartuar nëpërmjet një procesi konsultimi që përfshin aktorët lokalë dhe përfituesit e mundshëm nga të dyja anët e territorit të pranueshëm. Pyetësorët u hartuan nga ekipi CBIB+3 dhe u shpërndanë nga SO-të me mbështetjen e SPT-së tek institucionet në nivel qendror dhe lokal, si dhe te OSHC-të. Përgjigjet e mbledhura, së bashku me situatën dhe analizat SWOT, ndihmuan shumë në identifikimin e prioritetëve të përbashkëta për zonën ndërkufitare. Për më tepër, SO-të e Shqipërisë, të ndihmuara nga SPT-ja, organizuan një sërë takimesh me autoritetet vendore nga 8 bashkitë dhe 2 qarqet në zonën shqiptare të programit, pasi kishin shpërndarë pyetësorët mes tyre.

Siç ishte parashikuar, më 11 dhjetor 2020, filloi një konsultim publik në faqen e programit, në faqen e Zyrës së Integritimit Evropian të Malit të Zi, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, me afat për dorëzimin e komenteve 30 dhjetorin 2020. Për më tepër, drafti i parë i dokumentit të programit u dërgua në 534 adresa *email*-i, që i përkasin bazës së të dhënave të programit të palëve të interesuara. Komentet janë shqyrtuar tërësisht dhe shumica e tyre janë përfshirë në draftdokumentin e programit.

Gjatë procesit të programimit, konsultimet me anëtarët e TFP-së nga të dyja vendet pjesëmarrëse u bënë përmes shumë takimeve të mëdha dhe të vogla. Këta anëtarë dhanë të dhëna për analizimin e situatës, duke dhënë edhe komente mbi informacionet në seksione të veçanta. Meqenëse shumica e tyre përfaqësojnë organe të së drejtës publike në nivel qendror, rajonal dhe komunal, konsultimet programore brenda TFP-së duhet të shihen si kontributi më i rëndësishëm i ofruar nga autoritetet publike në të gjitha nivelet administrative. Për më tepër, këto organe luajtën një rol të rëndësishëm në renditjen e prioritetëve të programit kur iu përgjigjën pyetësorëve që shërbyen si material bazë për analizën SWOT të zonës së programit. Siç u theksua, Komuna e Kolashinit u vendosë unanimisht të përfshihet në Zonën e Programit nga TFP-ja më 20 prill 2021, pas procesit të konsultimit të dhjetorit 2020.

Në përputhje me komentet e Komisionit për draftin e parë të dokumentit të programit, OS-të e mbështetura nga projekti CBIB+3 dhe ekspertët punuan për draftin e dytë gjatë prillit 2021. U mbajt një tjetër aktivitet trajnimi me përfaqësuesit e projektit PROMEL mbi logjikën e ndërhyrjes në program. Komentet e Komisionit për draftin e dytë u morën më pas në fillim të qershorit 2021 me një afat kohor për dorëzimin e një draftdokumenti të tretë programor deri më 16 korrik 2021. Pikat e rëndësishme, takimet dhe ngjarjet e tjera që ndodhën gjatë procesit të programimit janë paraqitur në tabelën 1.1.

Tabela 1.1: Ngjarjet dhe momentet kryesore në procesin e programimit të BNK të IPA III ME-AL

Koha dhe vendi	Aktivitetet dhe fusha e veprimit
22 prill 2020	Një letër nga Komisioni Evropian, në lidhje me IPA III dhe fillimin e procesit të programimit është marrë nga Zyra e NIPAC
5 maj 2020	Takimi fillestar midis OS-ve të Shqipërisë dhe CBIB+3 mbi procesin e programimit të BNK-së IPA III (hapat e kërkuar dhe draftplani i punës)
6 maj 2020	Takimi fillestar midis AL OS dhe CBIB+3 mbi procesin e programimit IPA III BNK (hapat e kërkuar dhe draftplani i punës)
Fundi i korrikut 2020	Fillimi i procesit të emërimit të anëtarëve të TFP-së
4-7 gusht 2020	SPT-ja u dërgon pyetësorët palëve përkatëse të interesit për BNK-në
Fundi i gushtit 2020	Mobilizimi i ekspertit të programimit për këtë program
3 shtator 2020	AL OS takohet me përfaqësues të Bashkisë Lezhë dhe të Këshillit të Qarkut Lezhë
4 shtator 2020	AL OS takohet me përfaqësues të bashkive Kurbini dhe Mirditë
8 shtator 2020	AL OS takohet me përfaqësues të bashkive V. Dejës, Pukë dhe F. Arrëz
11 shtator 2020	AL OS takohet me përfaqësues të Bashkisë Tropojë
14 shtator 2020	AL OS takohet me përfaqësues të Bashkisë M. Madhe dhe të Këshillit të Qarkut Shkodër
23 shtator 2020	Takimi <i>online</i> me ekipin e CBIB+3 dhe ekspertët e programimit (ME AL & AL-KS)

28 shtator 2020	11 përgjigje nga pyetësorët e mbledhur iu dorëzuan ekspertit të programimit për elaborim dhe analizë të mëtejshme
9 tetor 2020	Uebinar <i>online</i> i organizuar nga CBIB+ për formulimin dhe zhvillimin e strategjisë BNK IPA III për anëtarët shqiptarë të TFP-së.
13 tetor 2020	Uebinar <i>online</i> i organizuar nga CBIB+ për formulimin dhe zhvillimin e strategjisë IPA III BNK për anëtarët malazezë të TFP, OS dhe stafin e SPT. Takimi vijues i OS-ve, ekipit të CBIB+3 dhe SPT-së mbi aspektet teknike të procesit të programimit.
29 tetor 2020	Takimi i parë <i>online</i> i TFP: rezultatet e pyetësorëve dhe prioritetet paraprake
11 nëntor 2020	Takimi i 2-të i TFP-së <i>online</i> : analiza SWOT dhe prioritetet paraprake
19 nëntor 2020	Takimi i 3-të i TFP-së në internet: diskutimi dhe miratimi i përzgjedhjes së prioritetëve bazuar në skenarët që rezultojnë nga analizat
1 dhjetor 2020	Takimi i 4-të i TFP-së <i>online</i> : diskutimi dhe miratimi i strategjisë së programit
4 dhjetor 2020	Dorëzimi i draftit të parë të Dokumentit të Programit në Komisionin Evropian
11 deri Në 30 dhjetor 2020	Konsultimi publik, nëpërmjet faqeve përkatëse të internetit (OS, JTS)
23 shkurt 2021	NIPAC në Mal të Zi merr zyrtarisht komentet e KE-së për draftin e parë të dorëzuar të dokumentit të programit
10 mars 2021	Takimi koordinues pas komenteve të pranura të Komisionit

Koha dhe vendi	Aktivitetet dhe objekti
12 mars 2021	Aktivitet trajnimi mbi logjikën e ndërhyrjes së programit ME-AL, nga Promel
16 prill 2021	Takimi koordinues për draftin e dytë të dokumentit të programit
20 prill 2021	Takimi i 5-të i TFP-së për draftin e dytë të dokumentit të programit
29 prill 2021	Dorëzimi i draftit të dytë të dokumentit të programit në Komisionin Evropian
8 qershor 2021	NIPAC në Mal të Zi merr jozyrtarisht komentet e Komisionit për draftin e dytë të dorëzuar të dokumentit të programit
16 qershor 2021	Takimi koordinues pas komenteve të pranura të Komisionit
21-29 qershor 2021	Procedura me shkrim për miratimin e draftit të tretë të dokumentit të programit nga TFP
16 korrik 2021	Dorëzimi i draftit përfundimtar të dokumentit të programit në Komisionin

2. Zona e programit

2.1 Analiza e situatës



Zona e programit të bashkëpunimit ndërkufitar në kuadrin e programit IPA III midis Malit të Zi dhe Shqipërisë zë një territor prej 12.781 km². Zona e programit ka ndryshuar me përfshirjen e komunës së Kolashinit në program. Territori i zonës së programit është pak më i madh në Mal të Zi, duke zënë rreth 52% kundrejt 48% në Shqipëri. Gjatësia e vijës kufitare është 244 km nga të cilat 38 km janë kufij ujorë të përbërë nga liqeni i Shkodrës, deti Adriatik dhe disa lumenj. Janë tre pika operative të kalimit kufitar tokësor dhe një e katërta në ndërtim e sipër. Zona e programit e Malit të Zi mbulon 14 komuna: Kolashin, Andrijevica, Berane, Plavë, Gusinje, Petnjica, Rozhaje, Podgoricë, kryeqytetin e Malit të Zi, Tuzi, Cetinja, Danilovgradi, Budva, Ulqin dhe Tivar. Zona e programit të Shqipërisë mbulon qarqet e Shkodrës (që përfshin bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrës), dhe Lezhë (bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin) dhe

Bashkinë e Tropojës. Zona e programit ka 23 komuna me gjithsej 1305 vendbanime, duke përfshirë qytetet dhe fshatrat.

Procesi i hartimit të prioriteteve dhe nevojave për programin BNK të IPA III për periudhën 2021–2027 përfshin një analizë të plotë të situatës lokale dhe një analizë SWOT. Kjo analizë tregon se nevojat dhe prioritetet e rajonit lokal nuk kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore nga Programi BNK i IPA II. Raportet e Komisionit Evropian për vendet e Politikës së Zgjerimit të BE-së vënë në dukje përparime në zhvillimin në Mal të Zi dhe në Shqipëri. Konkurrenca e biznesit dhe prodhimi bujqësor mbeten ende të ulëta, papunësia mbetet relativisht e lartë, niveli arsimor i pabarabartë dhe potenciali i lartë turistik dhe mbrojtja e mjedisit në rajonin ndërkufitar ende kërkon zhvillim të konsiderueshëm, ku mund të kontribuojnë prioritetet tematike dhe specifike të përcaktuara në programin operacional.

Rritja e turizmit, si një nga prioritetet tematike të përzgjedhura, do t'i shërbejë forcimit të ekonomive vendase. Më tej, raportet e vendit vënë në dukje nevojën për masa më cilësore punësimi që synojnë të rinjtë, gratë, minoritetet dhe punëkërkuessit e tjerë, si dhe intensifikimin e përpjekjeve në zbatimin e mbrojtjes sociale, veçanërisht për grupet vulnerabël dhe për forcimin e kapaciteteve dhe burimeve të qeverisjes vendore. Për më tepër, nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme për zbatimin e masave mjedisore, kryesisht në menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit, mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike.

Dokumentet e Strategjisë Indikative të Rishikuara 2014–2020 për Malin e Zi⁶ dhe Shqipërinë⁷, të publikuara në vitin 2018 tregojnë se nevojat e synuara nga Programi BNK i IPA-s janë ende të rëndësishme për zonën kufitare. Gjithashtu në këtë dokument, analiza e nevojave për Malin e Zi tregon se papunësia e lartë paraqet një problem të rëndësishëm për vendin, ndërsa për Shqipërinë kjo konfirmon se turizmi ende përballlet me sfida që lidhen me mungesën e aftësive të profesionistëve të turizmit dhe me aksesin e ulët të shërbimeve turistike, me mungesën e një oferte të qëndrueshme natyrore dhe kulturore, si dhe me koordinimin dhe planifikimin e dobët në këtë sektor. Për më tepër, një përafrim më i mirë i rezultateve arsimore me nevojat e tregut të punës mbetet një sfidë kryesore për vendin.

Një mësim i nxjerrë nga programi i mëparshëm (IPA II) identifikoi se jo të gjitha aspektet e një prioriteti specifik tematik ishin trajtuar dhe rezultatet ishin më të ulëta se sa pritej. Kjo diktoi nevojën për të vlerësuar progresin drejt treguesve të përcaktuar të programit përpara fillimit të thirrjes për propozime.

Të gjitha këto gjetje dhe rekomandime merren parasysh gjatë përgatitjes së këtij draftdokumenti përmes përzgjedhjes së prioriteteve tematike përkatëse.

Gjeografia

Zona e programit është zona ku ndodhen disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që ilustrojnë një biodiversitet të pasur, por shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve mjedisore. Zona e programit në Mal të Zi karakterizohet nga dallime të rëndësishme rajonale. Ka një profil të larmishëm gjeografik dhe klimatik, të ngarkuar me vargmale, fusha, lugina, lumenj, laguna dhe liqene. Zona e programit në Shqipëri paraqet kontraste të mprehta pasi alternon malet, kodrat, lumenjtë, liqenet dhe bregdetin e detit shumë afër njëri-tjetrit. Siç u sugjerua gjatë konsultimit publik, komuna e Kolashinit është strehëz e një shumëllojshmërie të pasur peizazhesh dhe relievesh (lumenj, male të larta dhe liqene akullnajore).

Demografia

Popullsia që jeton në zonën e programit është 754.190 banorë dhe përbën rreth 64,91% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi dhe 12,31% të popullsisë së Shqipërisë. Nga ana tjetër, popullsia në zonën e programit të Malit të Zi përbën 403.730 banorë ose 53,6%, kurse shqiptarët janë 350.460 banorë ose 46,4% e totalit të zonës së programit. Podgorica ka popullsinë më të

⁶ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180817-revised-indicative-strategy-paper-2014-2020-for-montenegro.pdf>.

⁷ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180817-revised-indicative-strategy-paper-2014-2020-for-albania.pdf>.

madhe si në vend, ashtu edhe në zonën e programit brenda ME-së.

Migrimi dhe dendësia

Zona e programit e të dyja vendeve ka përjetuar flukse të brendshme migrimi. Një lëvizje e popullsisë drejt rajoneve qendrore dhe bregdetare, të cilat janë gjerësisht më të zhvilluara dhe ofrojnë më shumë mundësi socio-ekonomike, si dhe nga qendrat rurale në ato urbane, është e pranishme në zonën e programit. Emigrantët e brendshëm vendosen në qytete në kërkim të punësimit, veçanërisht në sektorët e turizmit dhe ndërtimit. Dendësia më e ulët e popullsisë, distancat e gjata për lëvizje dhe disponueshmëria e dobët e objekteve sociale rrisin vështirësitë e njerëzve që banojnë në zonat rurale.

Varfëria

Në Mal të Zi pabarazitë rajonale janë të dukshme – varfëria është më e dukshme në rajonet veriore dhe zvogëlohet ndjeshëm drejt jugut në rajonet qendrore dhe bregdetare. Rritja e shkallës së varfërisë është shumë më e theksuar në zonat rurale, 35,6% krahasuar me zonat urbane ku ishte 17,3% në vitin 2018. Rajonet në zonën e programit të Shqipërisë janë më të varfra krahasuar me mesataren kombëtare të shkallës së varfërisë (14,3%). Qarku i Lezhës regjistron një normë varfërie prej 17.5%, ndërsa qarku i Shkodrës është pak më i mirë me një normë varfërie 15.7%. Varfëria është kthyer në një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërkohë që është bërë imperativ rigjallërimi i potencialit urban tashmë të shteruar për të udhëhequr rritjen ekonomike.

Gjatë kohës së hartimit të programit, ashtu si dhe pjesa tjetër e botës, Mali i Zi dhe Shqipëria u prekën në shumë fusha ekonomike dhe sociale nga pandemia e COVID-19. Kriza vijuese ka ekspozuar kufijtë e tolerancës fiskale të Malit të Zi dhe shkallën e lartë të cenueshmërisë së tij të përgjithshme ndaj goditjeve të jashtme. Mali i Zi tani duhet të përballë me recesionin e tij më të thellë në dy dekada. Aktiviteti ekonomik pritej të zbutej nga rritja prej 4.1% më 2019-n, por në vitin 2020 kriza e COVID-19 e tërhoqi ekonominë në një recesion të vlerësuar në -12.4%.

Shqipëria është ndikuar nga vështirësitë e Eurozonës, e cila është destinacioni i pothuajse 80% të eksporteve të saj dhe investitori më i madh në vend. Për më tepër, kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka ulur ndjeshëm rritjen në 7,5% të PBB-së në vitin 2020, duke reflektuar varësinë e saj nga turizmi dhe remitancat.

Sigurisht që ka të dhëna globale se COVID-19 po përkeqëson varfërinë, pabarazinë dhe cenueshmërinë e përjetuar nga familjet dhe fëmijët e tyre. Skemat e mbrojtjes sociale janë ndër ndërhyrjet më efektive në luftën kundër varfërisë dhe cenueshmërisë së fëmijëve dhe janë kyçe në krijimin e një mjedisi më mbrojtës për fëmijët. Megjithatë programi i ndihmës sociale ka rezultuar efektiv në shënjestrimin e më të varfërve, ai ende mund të mos përfshijë dhe përjashtojë disa grupe vulnerabel si: të varfrit që punojnë (veçanërisht si punëtorët informalë), gratë, pakicat, refugjatët dhe ata me pasuri dhe të ardhura pak mbi pragun e caktuar për të qenë përfitues.

Sektori privat

Në fushën e programit ka një numër në rritje të NVM-ve me aktivitete të larmishme.

Në Mal të Zi, numri i bizneseve në zonën e programit përbën rreth 71% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të vendit. Numri më i madh i subjekteve afariste në Mal të Zi dhe në zonën e programit është në Podgoricë, e cila përbën rreth 50% të numrit të përgjithshëm të bizneseve në zonën e programit.

Në Mal të Zi numri më i madh i njësive të biznesit bie nën subjektet e biznesit mikro dhe të vogël (98,7%). Situata pandemike ka ndryshuar shumë tregues në këtë sektor. Ndikimi i krizës në Mal të Zi reflektohet më tej në rënien e shitjeve dhe rritjen e humbjeve. NMVM-të dhe sipërmarrësit individualë janë më të rrezikuarit, duke pasur parasysh se ato zakonisht kanë më pak likuiditet dhe marzhe më të ulëta të kthimit, jo vetëm në Mal të Zi, por edhe globalisht.

Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit shqiptar dominohet gjithashtu nga MSME-të. Numri i përgjithshëm i sipërmarrjeve aktive në Shqipëri në tërësi është 162 343, ndërsa Shkodra zë 10 999 (7 në Shqipëri) dhe Lezha me 5 167 (9) dhe Tropoja (brenda qarkut të Kukësit, e cila është në fund në listën e renditjes). Vrojtimet treguan pothuajse të njëjtën situatë në këtë

sektor për Shqipërinë dhe Malin e Zi. Ka disa mënyra se si pandemia e koronavirusit ka prekur bizneset, veçanërisht MSME-të, si nga ana e ofertës ashtu edhe nga ana e kërkesës në Shqipëri.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Zona e programit është e pasur me burime bujqësore me potencial për investime dhe zhvillim. Karakteristika e përbashkët është se ajo bazohet në prona të vogla që janë operatorë idealë për investime në agro-produkte të mirëfillta të qëndrueshme, që mund të bëhen bioprodukte.

Sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Malit të Zi dhe është përgjegjës për një pjesë të konsiderueshme të PBB-së (6,4% më 2019). Statistikat tregojnë se punësueshmëria në sektorin e bujqësisë (përfshirë pylltarinë dhe peshkimin) është 8,3%. Ky sektor është një nga sektorët me potencial të lartë ekonomik për zhvillim në Kolashin, duke furnizuar tregun vendas me produkte të caktuara të një sektori bujqësor modern.⁸ Megjithatë, bujqësia malazeze karakterizohet nga një produktivitet më i ulët ku efikasiteti i punës është më i ulëti në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe lindshmëria u ul në dekadën e mëparshme për shkak të përdorimit joadekuat.

Sektori i bujqësisë është një nga më të rëndësishmit në ekonominë shqiptare. Produktet bujqësore janë pjesë e identitetit rajonal në një gamë të gjerë kushtesh mjedisore, natyrore dhe klimatike. Politika e zhvillimit bujqësor dhe rural është veçanërisht e rëndësishme në Shqipëri, pasi bujqësia kontribuon rreth 20% të PBB-së së vendit dhe punëson gati gjysmën e fuqisë punëtore të vendit. Rreth 37% e fuqisë punëtore të vendit janë të punësuar në sektorin e bujqësisë. Shumica e fermave në Shqipëri janë në pronësi të familjes dhe operohen në nivel familjar, që do të thotë se prodhimi i fermave është kryesisht për konsum vetjak dhe kanë teprica të kufizuara për treg.

Turizmi

Ekonomia e Malit të Zi është fuqimisht e varur nga turizmi, një burim kyç i rritjes së PBB-së, këmbimit valutor, punësimit dhe të ardhurave fiskale, me një pjesë prej gati 22% të PBB-së totale dhe me një tendencë të fortë drejt rritjes. Të ardhurat nga turizmi ndikojnë ndjeshëm si në bilancin e të ardhurave, ashtu edhe në punësim. Zona e programit, në kufi me Shqipërinë, ofron një shumëllojshmëri destinacionesh turistike që ofrojnë aktivitete turistike bregdetare dhe malore, pasuri të shumta të trashëgimisë kulturore, traditës rurale, artizanatit dhe një traditë të zhvilluar të ditëve të shënuara, festimeve dhe pelegrinazheve lokale. Komovi, si masiv malor që shtrihet midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, është një nga zonat tërheqëse me aktivitete kulturore dhe sportive kryesisht të vendosura në Kolashin dhe më e frekuentuara gjatë viteve të fundit nga shumë turistë shqiptarë.

Bregdeti i zonës së programit tërheq shumë turistë që hyjnë në Mal të Zi veçanërisht gjatë verës. Por me situatën pandemike të shkaktuar nga COVID-19, gjithçka ndryshoi. Siç u përmend më lart, Mali i Zi është veçanërisht i prekur nga rënia e turizmit, sektor që në kushte normale është shtytësi kritik i rritjes: të ardhurat nga turizmi përbëjnë më shumë se 20% të PBB-së. Sipas të dhënave të MONSTAT, pas rritjes ekonomike prej 2,7 për qind në tremujorin e parë, në tremujorin e dytë Mali i Zi shënoi një rënie prej 20,2 për qind, që është ndër normat më të larta të rënies në Evropë.

Në Shqipëri, turizmi ka vazhduar të rritet në mënyrë të qëndrueshme gjatë 3 viteve të fundit dhe është bërë shumë i rëndësishëm për ekonominë. Gjatë vitit 2017, sektori i turizmit regjistroi një kontribut të drejtpërdrejtë prej 1,12 miliardë dollarësh, duke zënë rreth 8,5% të PBB-së. Zona e programit të Shqipërisë është shumë e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, bazuar në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura në breg të detit dhe në brendësi, në traditat rurale dhe zejet, dhe në një traditë shumë të zhvilluar pelegrinazhi. Ka një natyrë të gjerë, potencial turistik kulturor dhe historik, i cili është kryesisht i pashfrytëzuar. Pandemia në Shqipëri ka pasur të njëjtin efekt si në Mal të Zi. Turizmi, që përfaqëson më shumë se 20% të PBB-së së Shqipërisë, ishte një nga sektorët më të prekur. Ndër të gjithë sektorët ekonomikë, turizmi është më i prekur me një mbyllje aktiviteteve prej 75%.

⁸ Burimi: Plani Zhvillimor Strategjik i Komunës Kolashin 2018–2022.

Mjedisi dhe natyra

Zona e programit është e pasur me burime mjedisore. Mali i Zi ka një diversitet të lartë biologjik për shkak të sfondit gjeologjik, klimës dhe afërsisë së detit dhe vargmaleve malore. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit janë shtyllat e të gjitha strategjive të zhvillimit të vendit. Së bashku me malet dhe ujin, pyjet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të markës së Malit të Zi në fushën e turizmit të qëndrueshëm dhe të gjelbër.

Në Shqipëri, zona e programit ka një pasuri biodiversiteti dhe klime pasi përfshin male, kodra, fusha, liqene, lumenj dhe vijë bregdetare. Ka parqe natyrore, rezerva natyrore të menaxhuara dhe peizazhe të mbrojtura me vlerën natyrore dhe biodiversitetin më të madh në vend.

Ndryshimet sociale dhe ekonomike të viteve të fundit, ndryshimet demografike si në Shqipëri ashtu edhe në Mal të Zi kanë bërë presion mbi mjedisin dhe biodiversitetin në zonën e programit. Masat e eficiencës së energjisë do të jenë një nxitje shtesë për të siguruar efikasitetin e burimeve dhe prodhimin më të pastër. Sfidat kryesore mjedisore që duhen përballuar në fushën e programit janë zbatimi i planifikimit strategjik urban, reduktimi i ndotjes, mbrojtja e tokës nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, menaxhimi i rrezikut dhe kapaciteti për të mbrojtur jetën, pronën dhe trashëgiminë natyrore të njerëzve.

Zona e programit është gjithashtu e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike. Rajoni i Ballkanit Perëndimor tashmë po përjeton ndryshime në kushtet klimatike të demonstruara nga një kohëzgjatje dhe frekuencë e shtuar e valëve të të nxehtit dhe të thatësirave; rritje e rrezikut të përmytjeve, degradimit të pyjeve për shkak të rritjes së shpeshtësisë së zjarreve dhe ndryshimeve në mbulesën e lirë; fillimi i hershëm i sezonit të rritjes dhe rreziku i lartë i ngricës së vonë të pranverës; ulje e cilësisë së rendimentit gjatë viteve me periudhë rritjeje më të ngrohtë dhe/ose më të thatë; dhe ulje mesatare të shkarkimit të lumit dhe problem me cilësinë dhe furnizimin me ujë të pijshëm veçanërisht gjatë sezonit të verës.

Infrastruktura

Pozicioni i zonës së programit nënvizon rëndësinë e një infrastrukture të mirë transporti në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, tregtisë, bujqësisë, shkëmbimeve kulturore, konkurrencës dhe sektorëve të tjerë të lidhur me to që ndikojnë në rritjen e PBB-së.

Mali i Zi vazhdon të marrë pjesë aktive në strategjinë e BE-së për zhvillimin e Rajonit të Danubit (EUSDR) dhe të dyja vendet marrin pjesë në strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR). Shqipëria merr pjesë aktive në rreth 35 organizata dhe iniciativa rajonale, si Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Komuniteti i Energjisë, Komuniteti i Transportit, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Rrugët

Gjatësia totale e rrugëve të Malit të Zi është afërsisht 7 000 km, nga të cilat rreth 1 850 km përbëhet nga rrugë kryesore dhe rajonale, ndërsa gjatësia e mbetur përbëhet nga rrugë lokale. Lidhjet midis Podgoricës dhe qyteteve bregdetare janë përmirësuar ndjeshëm, koha e udhëtimit është bërë më e shkurtër dhe rrugët më të sigurta me përfundimin e tunelit të Sozinës në vitin 2005 dhe përmirësimet e shumta të rrugëve drejt Cetinjes, Budvës dhe Barit. Aktualisht, seksioni 1 (Smokovac–Mateshevë) të autostradës së re, ka filluar në vitin 2015 dhe duhet të përfundojë deri në vitin 2021 (vetëm seksioni 1). Në zonën e programit shqiptar, infrastruktura rrugore është përmirësuar ndjeshëm në 5 vitet e fundit. Transporti i mallrave dhe njerëzve është më i lehtë dhe më i shpejtë tani. Udhëtimi për në Lezhë dhe Shkodër nga Tirana zgjat jo më shumë se 120 minuta.

Transporti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor i Malit të Zi përbëhet nga tre korridore hekurudhore (kryesisht) të elektrizuara, me matës standard, me një gjatësi totale prej 150 km. Këto hekurudha lidhin Portin e Tivarit me Podgoricën dhe Podgoricën me Shqipërinë (Hekurudha Podgoricë–Shkodër). Vlen të përmendet se Mali i Zi dhe Shqipëria kanë rënë dakord të integrojnë procedurat e organizimit të transportit hekurudhor ndërmjet vendeve.

Transporti ajror dhe detar

Aeroporti i Podgoricës në Mal të Zi është aeroporti kryesor në zonën e programit. Ekziston edhe aeroporti i Beranës që nuk funksionon (fluturimet e fundit kanë ndodhur gjatë viteve 1980) dhe aeroporti Špiro Mugoša në Podgoricë, një aeroport jokomercial që përdoret shpesh për hedhje me parashutë, rrëshqitje dhe sporte të tjera ajrore. Zona e programit në Mal të Zi është shtëpia e portit të Barit, më i madhi në Mal të Zi, dhe marinës në Budva. Një marinë tjetër në Tivar, afër portit të Tivarit, dhe një port i vogël në Ulqin. Në zonën e programit shqiptar ndodhet porti i Shëngjinit (rajoni i Lezhës), i cili shërben për nevojat e pjesës veriore të Shqipërisë për transport detar.

Telekomunikacioni, teknologjitë e informacionit

Telekomunikacioni në zonën e programit përfiton si nga telefonia tokësore (fiks), ashtu edhe nga ajo celulare. Në Mal të Zi, 72% e familjeve kanë akses në internet në shtëpi. Zhvillimet e rrjeteve të telekomunikacionit mbështeten kryesisht në sektorin privat. Në Shqipëri, numri i familjeve që gëzojnë akses në internet në shtëpi është rritur (nga 80,7% më 2017-n në 82,2% më 2018-n).

Energjia

Programi i Reformës Ekonomike 2019–2021 për Malin e Zi përcaktoi një masë reformuese prioritare të titulluar “përmirësimi i kuadrit legjislativ-rregullator dhe institucional për integrimin në tregun rajonal të energjisë elektrike” për një periudhë trevjeçare. Përfundimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi (Elbasan–Podgoricë) rrit kapacitetet e shkëmbimeve energjetike mes të dyja vendeve dhe lidh Shqipërinë me rrjetet rajonale dhe evropiane, duke rritur kështu sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend.

Aspekti social

Tregu i punës

Papunësia si në Mal të Zi, ashtu edhe në Shqipëri është relativisht e lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Është ende një problem i madh ekonomik në të dyja vendet dhe karakterizohet nga dallime të rëndësishme rajonale. Në Mal të Zi, struktura e personave të punësuar sipas sektorëve të veprimtarisë tregon se pjesa më e madhe e tyre punon në sektorin e shërbimeve, 74%; pastaj në industri dhe ndërtim, 17,7% dhe 8,3% në bujqësi, pylltari dhe peshkim. Papunësia afatgjatë mbetet një sfidë e madhe strukturore. Grupet më të cënueshme në tregun e punës mbeten gratë, të rinjtë, romët dhe punëtorët me kualifikim të ulët. Në vitin 2019 shkalla e papunësisë së popullsisë në moshë pune ishte 15,4% (15% për burrat dhe 15,9% për gratë).

Faktorë që ndikojnë në pozitën ekonomike të grave janë edhe mungesa e përfaqësimit politik të tyre, si dhe mungesa e vullnetit politik të vendimmarrësve për të adresuar sistematikisht çështjet që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave. Është konstatuar se një kulturë politike dhe biznesi e fokusuar tek meshkujt shpesh nuk ofron një mjedis ideal për diskutime publike, në lidhje me fuqinë e pabarabartë ekonomike midis grave dhe burrave. Për më tepër, politikat që lidhen me fuqizimin ekonomik janë më tepër *ad-hoc* sesa sistematike dhe zbatimi i tyre nuk monitorohet nga autoritetet shtetërore.⁹

Me situatën pandemike, të dhënat administrative tregojnë se deri në korrik 2020, punësimi kishte rënë me 9%. Mbi 80% e vendeve të punës në Mal të Zi janë në shërbime, të cilat janë prekur rëndë nga kriza. Megjithatë që të gjithë sektorët regjistruan rënie të punësimit, sektorët e turizmit intensiv të punës, tregtisë me pakicë dhe ndërtimit u goditën më rëndë.

Shqipëria është një ekonomi në tranzicion, jo shumë e integruar në flukset globale të kapitalit, por që shfaq performanca të forta ekonomike. Norma vjetore e rritjes së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i dytë 2019 deri në tremujorin e dytë 2020, ishte 3,6%. Në terma vjetorë, shkalla e punësimit u ul me 3,7% në sektorin e bujqësisë, 3,7% në sektorin e industrisë dhe 3,4% në sektorin e shërbimeve. Rinia në Shqipëri ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes dhe punësimit në fuqinë punëtore dhe normat më të larta të papunësisë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Tregu i punës vazhdon të tregojë pabarazi mes grave dhe burrave në Shqipëri. Të dhënat tregojnë

⁹ Grupi i Bankës Botërore, Raporti Ekonomik nr. 17 i Ballkanit Perëndimor, Pranverë 2020, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19, Përmbledhje.

punësim më të lartë të femrave sesa meshkujve vetëm në sektorët socialë si arsimi, shëndeti dhe mirëqenia.

Në Shqipëri, boshllëqet gjinore në mundësitë ekonomike përfshijnë pjesëmarrjen e ulët në fuqinë punëtore, nivele të larta informaliteti, ndarje gjinore dhe akses të ulët në inputet produktive. Ndikimet e COVID-19 dhe fatkeqësive të tjera natyrore e përkeqësojnë edhe më shumë situatën, veçanërisht për gratë dhe vajzat që në përgjithësi fitojnë më pak, kursejnë më pak dhe kanë punë të pasigurta ose jetojnë pothuajse në varfëri.

Arsimi dhe rinia

Sistemi arsimor në Mal të Zi menaxhohet në mënyrë të centralizuar, ndërsa në Shqipëri është i decentralizuar me përgjegjësi të ndara ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor. Nivelet e pabarabarta arsimore janë të pranishme në zonën e programit, me rritjen e analfabetizmit në zonat e thella. Shkollat private dhe trajnimi profesional janë të pranishme, por ende nevojiten përpjekje të tjera për të plotësuar kërkesat e tregut të punës për punëtorë të kualifikuar. Edhe komunitetet rreth duhet të integrohen më mirë në sistemin arsimor.

Kërkimi shkencor, TIK dhe inovacioni

Mali i Zi ka një kërkim shkencor në rritje dhe niveli i financimit është gjithashtu në rritje që nga viti 2017. Aksesit në financime për Kërkim Shkencor dhe Inovacion është përmirësuar përmes mbështetjes së trajnimit për të aksesuar financimet ndërkombëtare. Shqipëria është në një fazë të hershme në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor. Është bërë njëfarë progresi veçanërisht me përfundimin e fazës së hartëzimit të Strategjisë së Specializimit Inteligent.

Shëndeti

Organizimi i sistemit shëndetësor në Mal të Zi dhe Shqipëri është i ngjashëm: kryesisht publik me një prani modeste (por në rritje) të privatit dhe me mbulim të plotë territorial, duke përfshirë kujdesin shëndetësor parësor, sekondar dhe terciar. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është pika e parë e kontaktit të popullatës për të adresuar problemet e tyre shëndetësore. Institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime janë poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet speciale për fëmijë dhe këshillim për gratë.

Kultura

Kultura në fushën e programit në përgjithësi karakterizohet nga elemente të traditave të ndryshme individuale dhe të përbashkëta. Qendrat turistike dhe qytetet e mëdha janë të pasura me trashëgimi kulturore që përfshijnë monumente dhe kulte fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, lokalitete arkeologjike të hapura për turistët, rrënoja dhe muzeume të ndryshme. Zona e programit është gjithashtu e pasur me tradita të larmishme të kuzhinës dhe zejeve që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e turizmit. Investimet dhe subvencionet e kufizuara publike kanë mbajtur një nivel të ulët të aktiviteteve kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Kjo kërkon nisma të reja të përbashkëta që synojnë t'i shtojnë vlerë trashëgimisë së përbashkët në të dyja anët e territorit që përfitojnë nga ky program.

Zona e programit në Mal të Zi është shtëpia e një sërë besimesh, traditash dhe kulturash fetare. Zona e komunës së Kolashinit është e pasur me objekte kulturore.

Zona përmban një popullsi me përbërje të përzier etnike dhe fetare (malazezë, serbë, shqiptarë, boshnjakë dhe komunitet rom), me një histori të gjatë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Një histori dhe traditë e tillë përfaqëson një terren të mirë për nisma ndërkufitare pasi marrëdhëniet ndërkufitare dhe lidhjet kulturore janë të rrënjosura thellë në mendësinë e popullsisë së zonës së programit dhe përfaqësojnë një shtyllë të strukturës sociale në zonë.

Në Shqipëri, territori i programit është i pasur me trashëgimi kulturore. Krahë kalasë së famshme të Rozafës, në Shkodër gjenden disa muze dhe një numër i konsiderueshëm objektesh arkeologjike dhe atraksionesh turistike në rajon dhe në qytet. Lezha, një park arkeologjik që nga viti 2005, ka gjithashtu rrënojat e kështjellës së saj që dominojnë qytetin, së bashku me atraksione të tjera që mund të gjenden në rajon si muzetë dhe kishat.

Shoqëria civile

Janë 5932 OSHC të regjistruara në Mal të Zi (417 të regjistruara gjatë vitit 2019), 4062 janë të regjistruara në zonën e programit. OSHC-të më me ndikim dhe me përvojë i kanë selitë në Podgoricë (2392 që përbëjnë më shumë se 50%) dhe janë aktive në sektorë të ndryshëm (të drejtat e njeriut, politikat publike, mjedisi dhe zhvillimi rural, ngritja e kapaciteteve, personat me aftësi të kufizuara etj.). Shumica prej tyre kanë përvojë në hartimin e projekteve BNK. Në rajonet e tjera dhe veçanërisht në rajonin verior, situata e OSHC-ve është më e pasigurt. Zyrtarisht janë 11739 OSHC të regjistruara në Shqipëri (313 të reja të regjistruara më 2019). Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet (Tiranë), ose në rajonin qendror (i cili përfshin Tiranën dhe qytetet kryesore si Shkodrën, Durrësin, Elbasanin dhe Korçën). Shoqëria civile është e përfaqësuar dobët në të gjitha zonat rurale. OSHC-të i përkushtohen kryesisht advokimit dhe kërkimit shkencor në fushat e promovimit të të drejtave të njeriut, mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve, demokracisë dhe mirëqeverisjes, si dhe grupeve të ekspertëve të politikave dhe zhvillimit ekonomik. Qasja në financimin shtetëror dhe privat është e kufizuar.

Kuadri ligjor i autoriteteve ligjore rajonale

Mali i Zi është shtet unitar. I vetmi nivel nënkombëtar formohet nga 24 bashki dhe nuk ka rajone apo nivele të tjera ndërmjetëse të qeverisjes. Gjatë procesit të reformës së Malit të Zi, “Ligji për zhvillimin rajonal” i vitit 2011 e ndau vendin në tre rajone për qëllime statistikore, pa kompetenca legjislative apo zbatuese që u jepeshin atyre rajoneve. Në Shqipëri, qeverisja vendore ka pësuar një sërë reformash strukturore dhe institucionale, duke filluar nga Reforma Administrative dhe Territoriale, e cila synonte transformimin e cilësisë së qeverisjes vendore duke forcuar autonominë vendore, rritjen e kapaciteteve institucionale të administratave vendore dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Ligji “Për ndarjen territoriale dhe administrative të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në korrik 2014 dhe në fuqi që prej dhjetorit 2014, e ndan vendin në 12 prefektura dhe 61 bashki.

2.2 Gjetjet kryesore

Zona e programit ndan vlera dhe veçori të përbashkëta, por në të njëjtën kohë është e larmishme, gjë që përfshin një potencial të madh për t’u angazhuar në iniciativa ndërkufitare dhe për të transferuar njohuritë, për të punuar së bashku, për të krijuar sinergji për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe për të rritur zhvillimin ekonomik. Disa veçori specifike që vlen të përmenden janë natyra, pozicioni gjeografik, tendencat demografike, ekonomia dhe burimet njerëzore.

Programi duhet të ndërtohet mbi praktikën më të mira dhe pasurinë e iniciativave të ndërmarra përmes IPA I dhe II BNK midis të dyja vendeve dhe programeve të tjera ETC si Itali–Shqipëri–Mali i Zi, Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jon, dhe programet e Bashkimit si Erasmus. Plus, Creative Europe, EaSI, Europe for Citizens, Horizon Europe, COSME etj. të cilat janë në programim edhe për vitet 2021–2027 dhe ku marrin pjesë të dyja vendet. Këtu përfshihen IPARD II dhe IPARD III.

Gjetjet bazë të zonës së programit për BNK janë paraqitur më poshtë:

- **Karakteristikat ekonomike** të të dyja vendeve tregojnë tendenca të ngjashme. Megjithatë, struktura e ekonomive të tyre është paksa e ndryshme. Mali i Zi është një ekonomi e vogël dhe e hapur, kurse Shqipëria është një ekonomi në tranzicion. Megjithatë, të dyja anët e zonës së programit po bëhen gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj, por ka nevojë nga të dyja palët për të përmirësuar kushtet dhe veçanërisht infrastrukturën për të bërë biznes. Investimet në turizëm, energji të rinovueshme dhe bujqësi mund të jenë sektorë potencialë për tërheqjen e më shumë IHD-ve. Industria e lehtë dhe industria e përpunimit të ushqimit konsiderohen gjithashtu si një potencial për rritje të përsheptuar ekonomike në zonën e programit. Ndërkohë, rajonet shqiptare mbështeten te bujqësia, shërbimet, tregjet me shumicë dhe me pakicë; rajonet malazeze kanë industri më të zhvilluar (industrinë e drurit, lëkurës etj.) dhe niveli i turizmit është shumë i zhvilluar. Bujqësia është zakonisht e rëndësishme për të dyja palët.

- **Bujqësia** është një potencial i madh ekonomik në fushën e programit. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, shumë më shumë në anën shqiptare, dhe ekonomitë e vogla bujqësore e kanë të vështirë të hyjnë në tregje. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama

e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë komplementare sesa konkurruese. Përmirësimi i efikasitetit në bujqësi për zhvillimin e burimeve shtesë të të ardhurave, duke ruajtur pasuritë natyrore dhe gjetjen e sinergjive me turizmin, do të ishte një potencial. Përmirësimi i mëtejshëm i aksesit në tregje, veçanërisht për produktet vendore, investimet në infrastrukturën rurale dhe menaxhimi më i mirë i burimeve ujore mund të jenë gjithashtu prioritetet në zonën e programit. Modernizimi i bujqësisë, përmirësimi i proceseve të prodhimit dhe vendosja e standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore janë sfida që duhen trajtuar në fushën e programit. Iniciativat ndërkufitare mund të mbështesin dhe promovojnë: i. diversifikimin e aktiviteteve rurale (p.sh. akomodimin turistik në ferma); ii. aksesin në tregje dhe zhvillimin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore organike dhe artizanatit; iii. mbrojtjen (p.sh. emërtimin e mbrojtur të origjinës) dhe tregtimin e produkteve tradicionale bujqësore dhe agroushqimore; dhe iv. bashkëpunimin ndërmjet fermerëve dhe prodhuesve të tjerë. Në kontekstin e turizmit rural, duhet të gjenden komplementaritetet ndërmjet këtij programi dhe IPARD II, dhe IPARD III, në lidhje me operacionet që mbështesin turizmin rural dhe produktet bujqësore për të ndihmuar në diversifikimin e produkteve dhe të shërbimeve turistike.

- **Papunësia** mbetet një problem për popullsinë e zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme shoqërore si të rinjtë dhe popullsia rurale, gratë, romët. Pasiguria e punësimit konsiderohet si arsyeja kryesore për një shkallë të lartë migrimi, veçanërisht në zonat rurale ose më pak të zhvilluara ku shkalla e papunësisë është e lartë si rezultat i prodhimit bujqësor të vogël dhe sa për mbijetesë. Çështje të tilla mund të trajtohen shumë mirë në turizëm së bashku me praktikatat bujqësore të qëndrueshme dhe inovative, duke qenë shtylla kurrizore e ekonomisë së Malit të Zi dhe strategjike për nxitjen e punësimit për Shqipërinë.

- **Mbrojtja e mjedisit** duhet të merret seriozisht në konsideratë në planet e ardhshme të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit që mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, kontrolli i ndotjes, masat e ripyllëzimit, blegtoia e qëndrueshme, përdorimi efikas i burimeve të energjisë, administrimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu, si dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës janë ndër prioritetet kryesore që duhen adresuar nga planet e zhvillimit qeveritar dhe lokal. Valorizimi i mëtejshëm i burimeve natyrore për zhvillim ekonomik është një çështje kyçe në këtë zonë, veçanërisht nga pala shqiptare.

- Zona e programit ka një potencial të lartë turistik, por mundësi të tilla shfrytëzohen kryesisht nga ana e Malit të Zi, ndërkohë që turizmi në anën shqiptare është ende në zhvillim me vëmendje dhe fokus në rritje si nga politikëbërësit kombëtarë ashtu edhe ata vendorë. Duhet të merren parasysh iniciativat BNK që synojnë të prodhojnë një ofertë të përbashkët turistike. Sinergji të dukshme, potencialisht për t'u mbështetur nga programi BNK, mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi (duke u zhvilluar brenda zonës së programit dhe turizmit bregdetar që mund të shërbejë si urë lidhëse), por edhe me “zona më pak turistike” në Malin e Zi Verilindor, i cili ka karakteristika të ngjashme sa i përket mjedisit, natyrës së egër dhe maleve me veriun e Shqipërisë. Ekziston nevoja për të zhvilluar një ofertë të larmishme turistike, duke përfshirë kuzhinën malore dhe agroturizmin, në të gjithë zonën e programit. Si e tillë, infrastruktura e përmirësuar në Alpe, Tamarë dhe në Bjeshkët e Nemuna, mund të mbështetet me zhvillimin e produkteve të reja të integruara dhe rajonale. Një potencial i fortë është turizmi kulinar i bazuar në traditën shqiptare dhe malazeze, në prodhimin e verërave vendase dhe produkteve të tjera që mund të promovohen dhe zhvillohen së bashku.

- Në territorin e programit ka një trashëgimi të pasur historiko-kulturore-artistiko-fetare që duhet ruajtur. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë së saj historike dhe kulturore, dhe sinergjitë me turizmin fetar mund të kontribuojnë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një aset për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të programit. Bashkëpunimi kufitar ndërmjet institucioneve kulturore tashmë ekziston, por mund të intensifikohet më tej.

- Përmirësimi i kurrikulës arsimore është një prioritet kryesor për fushën e programit, duke u

fokusuar tek të rinjtë dhe grupet e marxhinalizuara. Programi BNK do të ketë një rol të kufizuar në adresimin e këtyre çështjeve, por mund të mbështesë shkëmbimet ndërmjet shkollave dhe qendrave të formimit profesional në zonat kufitare. Prania e universiteteve dhe qendrave kërkimore në të dyja anët e zonës së programit është një pasuri për programin BNK dhe një mundësi jo vetëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit akademik, por edhe për iniciimin e programeve të kërkimeve shkencore në zonën kufitare dhe në disa sektorë si bujqësia apo turizmi.

- Duke qenë se sektori i shëndetësisë menaxhohet në mënyrë të centralizuar, gjykohet se ka një numër të kufizuar masash që mund të ndërmerren në kuadër të programeve BNK. Megjithatë, konsiderohet se mund të ketë vend për aktivitete të përbashkëta potenciale, në lidhje me fushatat parandaluese shëndetësore dhe me edukimin shëndetësor.

Qeveritë lokale dhe rajonale shihen të dobëta financiarisht, pa mjetet e nevojshme për të nxitur zhvillimin lokal. Ato duhet të bëjnë përpjekje shtesë për menaxhimin, kontrollin financiar dhe buxhetimin, si dhe për përqafimin e qasjeve demokratike në proceset e vendimmarrjes. Bashkëpunimi ndërmjet pushteteve lokale dhe rajonale mes të dyja vendeve mund të avancojë më tej.

3. Strategjia e Programit

- Arsytimi - Arsytimi për strategjinë e përzgjedhur të ndërhyrjes

Në seksionin e mëparshëm, u shqyrtuan të dhënat statistikore që i përkasin zonës së programit, u studiua një vëllim i madh dokumentesh strategjike dhe u prezantuan rezultatet e konsultimeve me një sërë palësh të interesuara, për shembull nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar dhe takimeve tematike të kryera nga OS-të dhe SPT-ja gjatë fazës së programimit, si dhe gjatë takimeve të mbajtura të TFP-së. Gjetjet u prezantuan më pas dhe u diskutuan me OS-të dhe TFP-në përgjegjëse për përpjekjet e programimit në përputhje me parimin e koordinimit.

Në seksionin e katërt të këtij dokumenti do të prezantohet paketa financiare që do të vihet në dispozicion për financimin e zbatimit të këtij programi shtatëvjeçar BNK.

Por në seksionin aktual dhe më të rëndësishmin, do të përshkruajmë grupet/prioritetet tematike, siç janë përzgjedhur pas analizave socio-ekonomike dhe analizës SWOT, dhe një konsultimi të gjerë me palët e interesuara të BNK-së. Për përzgjedhjen e prioritetëve janë marrë në konsideratë strategjitë kombëtare të IPA-s dhe dokumentet e shumë vendeve për të parë më në detaje mënyrat për të krijuar një vlerë të shtuar në programe, duke theksuar sinergjitë dhe mungesën e mbivendosjeve.

Janë marrë në konsideratë edhe dokumente të tjera strategjike, si Axfenda e Gjellbër dhe Deklarata e Tiranës për protokollet e përbashkëta rajonale për të mbështetur rimëkëmbjen dhe rritjen e turizmit në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, të miratuara nga Ministrinë e Turizmit të të gjashta vendeve.

Prioritetet e përzgjedhura kontribuojnë në hapjen e rrugës për zhvillimin ekonomik të zonës së programit përmes mbrojtjes së mjedisit, përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut, si dhe përmes përmirësimit të mjedisit të biznesit dhe konkurrencës.

Strategjia është zhvilluar duke marrë parasysh lidhjet ndërmjet prioritetëve të ndryshme dhe ndikimeve të operacioneve tashmë të zbatuara. Për shembull, 'përmirësimi i kapaciteteve për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe menaxhimit' ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit dhe në konkurrencë, ndërkohë që ka ndikime indirekte në zhvillimin e turizmit.

Objektivi i Programit

Promovimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, nxitja e integritimit në Bashkimin Evropian dhe ofrimi i kontributit në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Prioritetet tematike të cilat janë zhvilluar në bazë të një analize të plotë të situatës në të dyja vendet me fokus të veçantë në fushën e programit dhe janë si më poshtë:

1. Grupimi tematik 2: Efikasiteti më i gjelbër dhe i përmirësuar i burimeve

TP2: Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut

Zona e programit është e pasur me burime mjedisore dhe ka një diversitet të lartë biologjik që përfshin male, kodra, fusha, bregdet, parqe natyrore, liqene dhe lumenj. Ruajtja e mjedisit dhe mbrojtja e këtyre burimeve janë shtylla të të gjitha strategjive zhvillimore në të dyja vendet dhe konsiderohen si prioritet i lartë nga të dyja qeveritë. Menaxhimi i përmirësuar i mbetjeve, kontrolli i ndotjes, përdorimi efikas i burimeve të energjisë, administrimi i fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, si dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës janë ndër prioritetet kryesore që duhen adresuar nga planet e zhvillimit qeveritar dhe lokal. Duke marrë parasysh rëndësinë e tij në zhvillimin ekonomik të zonës, anëtarët e TFP-së ranë dakord njëzëri për zgjedhjen e këtij prioriteti tematik për të adresuar më mirë nevojat e zonës së programit.

Për më tepër, përmbajtja e këtij prioriteti tematik është zhvilluar sipas dispozitave të përcaktuara në dokumentet strategjike kombëtare:

- Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për Zhvillimin dhe Integrimin 2014–2020 parashikon se nevojat për investime në nënsektorin e ujit janë thelbësore, ndërkohë që ka kapacitete të kufizuara menaxhimi. Ndiqja e dhënë duhet të parashikohet që të mbështesë elemente të ndryshme bazë të një qasjeje sektoriale si zhvillimin e një strategjie, planifikimin e buxhetit, zhvillimin institucional dhe organizativ, dhe koordinimin.

- Dokumenti indikativ i strategjisë për Malin e Zi thekson se ndërhyrja e ndihmës duhet të fokusohet në transpozimin dhe zbatimin e *acquis*-së së ujit, në përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve lumore dhe në krijimin e kushteve për krijimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të ujit.

- Ky prioritet bazohet edhe në rishikimin e dokumenteve të tjera ndërkombëtare siç është Korniza Sendai e OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030.

2. Grupimi tematik 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë

Zona e programit ka shumë subjekte biznesi të dominuara nga NMVM-të, të cilat luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e saj ekonomik. Megjithatë, konkurrenca kërkon vëmendje pasi është ende e dobët në të dyja anët e kufirit. Produktiviteti më i lartë dhe investimi i mëtejshëm në njohuritë dhe përdorimin e teknologjive inovative janë parakushte për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në zonat kufitare, bizneset zakonisht shfrytëzojnë mundësitë e tregtisë përtej kufirit dhe ato ndërkombëtare. Përvoja e mëparshme gjatë zbatimit të programeve IPA ka treguar se duhet t'u ofrohet më shumë mbështetje NMVM-ve që operojnë në fushën e programit përmes ngritjes së kapaciteteve dhe nismave të përbashkëta për promovimin e produkteve dhe zanateve vendore. Gjithashtu, papunësia mbetet një çështje për t'u trajtuar më tej në mesin e popullatës së zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme shoqërore si të rinjtë dhe popullsia rurale, gratë, romët dhe është arsyeja kryesore për një shkallë të lartë migrimi.

Përzgjedhja e këtij prioriteti tematik është në përputhje me nevojat dhe sfidat e paraqitura në dokumentet e mëposhtme:

- Dokumenti strategjik i vendit për Shqipërinë parashikon, midis rezultateve që lidhen me këtë fushë ndërhyrjeje, nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke rritur kështu integrimin e Shqipërisë në tregjet rajonale dhe të BE-së; përmirësimin e konkurrencës së përgjithshme të sektorit bujqësor dhe zonave të qëndrueshme rurale.

- Dokumenti indikativ i strategjisë për Malin e Zi thekson se si Mali i Zi gjithashtu duhet të përmirësojë mjedisin e biznesit, duke zhvilluar aksesin në infrastrukturën e informacionit për të reduktuar si ndarjen digjitale brenda vendit ashtu edhe hendekun me BE-në. Ai gjithashtu duhet të mbështesë aftësinë e industrive tradicionale për të konkurruar dhe për të inovuar përmes përmirësimeve të TIK-ut, trajnimit dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm për rritjen e konkurrencës së ekonomisë së vendit përfshin përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të politikës së kërkimit dhe inovacionit, si dhe forcimin e lidhjeve të saj me bizneset.

PT5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore e natyrore.

Zona e programit karakterizohet nga një potencial i lartë turistik, por mundësi të tilla ekonomike duhet ende të zhvillohen duke rritur vëmendjen dhe fokusin si nga politikëbërësit kombëtarë ashtu edhe ata vendorë. Gjithashtu, duke marrë parasysh ngjashmëritë mes të dyja vendeve për sa i përket mjedisit, natyrës së egër, zonave malore dhe bregdetare, programi ofron një mundësi të mirë për zhvillimin e ofertave të përbashkëta turistike dhe për prodhimin e produkteve vendase që duhet të promovohen dhe të zhvillohen më tej.

Për sa i përket kulturës dhe trashëgimisë natyrore, zona e programit është e pasur me asete kulturore që përfshijnë monumente dhe objekte fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, rrënoja arkeologjike, kështjella dhe muze të ndryshëm. Zona e programit është gjithashtu e pasur me tradita të larmishme të kuzhinës dhe zejeve që luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe në zhvillimin e turizmit. Investimet dhe subvencionet e kufizuara në sektorin publik kanë çuar në një nivel të ulët të aktiviteteve kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Kjo kërkon nisma të reja të përbashkëta që synojnë t'i shtojnë vlerë trashëgimisë ndërkufitare. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet institucioneve kulturore është tashmë i pranishëm, por kjo mund të intensifikohet më tej.

Ky prioritet kontribuon në mbulimin e nevojave dhe në arritjen e rezultateve kryesore të pritshme siç tregohet në dokumentet e mëposhtme:

- Dokumenti i strategjisë së vendit për Shqipërinë thotë qartë se fondet IPA mund të parashikojnë edhe asistencë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Potenciali i NMVM-ve veçanërisht në industrinë e turizmit është i pashfrytëzuar. Lidhja e turizmit me ruajtjen e natyrës dhe trashëgimisë kulturore mund të luajë një rol më të fortë për të nxitur rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

- Dokumenti strategjik indikativ për Malin e Zi konsideron turizmin, energjinë, bujqësinë dhe zhvillimin rural si fushat kryesore me potencial të madh për rritje ekonomike. Prandaj, reformat për përmirësimin e konkurrencës ekonomike dhe inovacionit duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre sektorëve ekonomikë. Kjo përfshin, ndër të tjera, përmirësimin e mjedisit të biznesit, performancën rregullatore dhe aksesin në kapital për NMVM-të.

- Deklarata e Tiranës për protokollin e përbashkëta rajonale për të mbështetur rimëkëmbjen dhe rritjen e turizmit në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, miratuar nga Ministritë e Turizmit të të gjashta vendeve të Ballkanit Perëndimor, është e një rëndësie të madhe pasi e konsideron turizmin si një motor për rritjen e një ekonomie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, dhe një sektor strategjik kyç për rimëkëmbjen rajonale në të ardhmen. Bashkëpunimi me sektorin privat konsiderohet po aq i rëndësishëm edhe në këtë strategji programore.

3. PT 0: Asistenca teknike

Një tabelë me shpjegimin e përmbledhur të prioriteteve tematike që janë përzgjedhur:

Tabela 3.1: Arsyetimi sintetik i prioriteteve tematike

Përpjesëtim tematike të zgjedhura	Arsyetimi për përzgjedhjen
1 - Grupimi tematik 2: <u>Efikasiteti më i gjerë dhe i përmirësuar i burimeve</u> PT2: Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	Zona e programit ka potenciale të mëdha për t'u eksploruar brenda sferës mjedisore. Ky prioritet mund të kontribuojë shumë në artikulimin e një reagimi të komuniteteve lokale ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimin e masave për parandalimin e rrezikut dhe menaxhimin. Mund të konsiderohet se tregon vazhdimësi me rezultatet e arritura përmes projekteve IPA II. Ka një efekt të lartë ndërkufitar duke pasur parasysh faktin se institucionet dhe organizatat që kanë përvojë në këtë fushë mund të adresojnë nevojat e përbashkëta në zonë përmes organizimit të masave të ndryshme të përbashkëta që mund të çojnë në zgjidhje të përbashkëta kundër ndikimit specifik të ndryshimeve klimatike në pyje dhe në toka bujqësore (p.sh. brumbulli i lëvores, ujëta, stuhitë me breshër etj.), parandalimi i përmytjeve, zjarreve, thatësirave etj. Ai gjithashtu do të përmirësojë kapacitetet e shërbimeve të parandalimit të fatkeqësive, do të rrisë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve përkatëse dhe bashkëpunimin me OSHC-të. <i>Për ta përmbledhur:</i> - Zona e programit është shtëpia e disa parqeve kombëtare, zonave të mbrojtura dhe peizazheve që pasqyrojnë biodiversitetin e pasur dhe shumëllojshmëri të madhe mjedisore.

	- Ka një biodiversitet të pasur, mjedis të paprekur dhe tërheqës, shumëllojshmëri peizazhesh natyrore; - Duhet të rritet ndërgjegjësimi i publikut për masat dhe për menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit; - Duhet të promovohen mekanizma të përbashkët të përmirësuar për të menaxhuar fatkeqësitë natyrore si: përmbytjet, zjarret, tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera - në përputhje me Kornizën Sendai të OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030 45% e fondeve IPA do të shkojë për këtë TP
2 - Grupimi tematik 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë TP5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore e natyrore;	Turizmi i bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore është i një rëndësie të madhe për zonat e programit BNK. Ofron mundësinë për t'u mbështetur te projektet e zbatuara më parë, për të kontribuar më tej në diversifikimin e ofertës turistike në zonë dhe nëpërmjet iniciativave BNK, për të shfrytëzuar burimet ende të pashfrytëzuara, kapacitetet e zonave rurale dhe potencialet e pashfrytëzuara. Kjo mundëson kombinimin e turizmit me bujqësinë, pasi ky perceptohet si një potencial kryesor ekonomik në zonë. Në kuadrin e këtij prioriteti mund të trajtohet edhe papunësia, që përbën një problem të madh për këtë zonë. <i>Për ta përmbledhur:</i> - Zona e programit është e pasur me burime natyrore që janë shumë të favorshme për zhvillimin e turizmit dhe shtysa kryesore ekonomike për të rritur mundësitë për mirëqenien dhe prosperitetin e banorëve në zonën e programit. - Një shumëllojshmëri destinacionesh turistike që ofrojnë aktivitete turistike bregdetare dhe malore, si dhe një pasuri e trashëgimisë arkitekturore, natyrore, kulturore dhe vende fetare mund të promovohen lehtësisht. - Në zonat rurale dhe të thella, të gjitha llojet e turizmit që lidhen me sportet malore (ski, ecje, biçikletë, rafting etj.) kanë një potencial të qartë. - Zona e programit është e pasur me tradita të larmishme të kuzhinës dhe zejeve që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e mëtejshëm dhe në zhvillimin e turizmit. - Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve bujqësore dhe industrisë agropërpunuese dhe industrisë së drurit, zejtarisë mund të lidhet me turizmin. - Sistemi arsimor mund t'u ofrojë të rinjve mundësi për t'u angazhuar në sipërmarrje në turizëm dhe për të avancuar shërbime dhe produkte cilësore dhe konkurruese. - Inovacioni dhe TIK-u duhet të aplikohen në një turizëm të bazuar te kultura dhe trashëgimia natyrore. - Mundësitë për të krijuar një produkt turistik të integruar përfshijnë zonat liqenore, bregdetare dhe malore. 45% e fondeve IPA do të shkonte për këtë TP.
PT0 – TA	10% e fondeve IPA do t'i dedikoheshin Asistencës Teknike TP0.

3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit

Kuadri i Programimit IPA III përmban treguesit e mëposhtëm mbi objektivat strategjike të IPA III BNK, të përbashkëta për të gjitha programet IPA III BNK:

Tabela 3.2: Treguesit strategjike të programimit IPA III

Objektivat strategjike IPA III për BNK	TREGUESI	BAZA* (2021)	TARGETI (2029)
<i>Pajtimi, ndërtimi i besimit dhe i marrëdhënieve të sqinjësishme së mirë</i>	Numri i organizatave që marrin pjesë në rrjetet/partneritetet e formuara ndërkufitare, të zërthyera sipas llojit të organizimit (veçanërisht shoqatat e grave)	201	307
Objektivat strategjike IPA III për BNK	TREGUESI	BAZA* (2021)	TARGETI (2029)
	Numri i organizatave të përfshira drejtpërdrejt në zbatimin e projekteve, i ndarë sipas llojit të organizatës (veçanërisht shoqatat e grave)	214	474
<i>Zhvillimi ekonomik, social dhe territorial i zonave kufitare</i>	Numri i vendeve të reja të punës që rezultojnë nga aktivitetet e programit, të ndara sipas gjinisë dhe moshës së punonjësve të rinj	0	24
	Numri i bizneseve të reja të krijuara, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës së pronarëve	0	61
<i>Ngritja e kapaciteteve të institucioneve në të gjitha nivelet</i>	Numri i organizatave/institucioneve me kapacitete të shtuara, të ndara sipas llojit të organizatave (veçanërisht shoqatat e grave)	0	62

* Situata bazë është përcaktuar në bazë të vlerave të arritura të projekteve të kontraktuara në kuadër të programit IPA II ME-AL, siç raportohet më 31 mars 2021. Burimi i të gjithë këtyre treguesve do të jetë sistemi rajonal i monitorimit. Megjithatë, të dhënat janë marrë siç raportohen nga përfituesit e grantit dhe jo të gjithë janë verifikuar domosdoshmërisht në momentin e nxjerrjes nga sistemi.

Përfituesit e programit do të raportojnë gjithashtu për këta tregues në çdo raport vjetor të

zbatimit të programit. Të dhënat për llogaritjen e vlerave të treguesve do të mblidhen nga projektet e zbatuara sipas prioriteteve tematike të përzgjedhura. Sistemi rajonal i monitorimit do të ndihmojë në këtë detyrë me të dhënat e nevojshme.

Pasqyra e strategjisë së programit

1 - Grupimi tematik 2 - Efikasiteti më i gjelbër dhe i përmirësuar i burimeve

TP2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut

Zgjedhja e këtij grupimi përfshin investimet për të siguruar qëndrueshmëri ndaj fatkeqësive nga rreziqe specifike, nëpërmjet edukimit në shkolla dhe forcimit të shërbimeve publike, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Prandaj, do të përpiqet të përmirësojë mbrojtjen e mjedisit, elasticitetin e komuniteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, gatishmërinë ndaj rrezikut dhe menaxhimit të fatkeqësive. Veprimet sipas këtij grupimi do të rezultojnë në:

- **Përmirësimin e kapaciteteve për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe menaxhimit.** Për ta arritur këtë, programi mund të ndërmarrë investime për adresimin e rreziqeve specifike, sigurimin e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive, luftën kundër dëmtuesve të pyjeve dhe tokave bujqësore, parandalimin e përmytjeve, zjarreve, thatësirave, stuhive etj., investime për infrastrukturën e vogël (p.sh. sistemet e synuara të ujitjes), reagimin e koordinuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu (përfshirë protokollet e përbashkëta të shpëtimit dhe procedurat operacionale, pajisjet për organet publike përgjegjëse), ngritjen e kapaciteteve të shoqatave të qytetarëve dhe autoriteteve lokale për të nxitur qasje inovative të menaxhimit mjedisor, nisma për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në rrezik, promovimin e iniciativave të gjelbra në zonat urbane (p.sh. masat për eficiencën e energjisë si emetimet e gazeve serrë dhe ndotës të tjerë).

- **Forcimin e mbrojtjes së mjedisit përmes kontrollit të ndotjes dhe forcimit të shërbimeve publike.** Aktivitetet sipas këtij rezultati përfshijnë veprime për luftimin e ndotjes, mbështetje specifike për mobilizimin e investimeve të gjelbra duke u fokusuar në burimet kyçe të ndotjes ose potencialet kyçe të rritjes së gjelbër në rajon – të tilla si: ndarja e mësimave të nxjerra dhe testimi pilot i zgjidhjeve praktike për marrjen e energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë në ndërtesat industriale, ndërtesat publike dhe familjare, mbështetje për bujqësinë e qëndrueshme (përmes kombinimit të potencialeve të prodhimit vendor me kërkesën e jashtme, certifikimit të produkteve bujqësore vendase ose integritetit të prodhuesve vendas në zinxhirët kryesorë të furnizimit me produkte bujqësore të qëndrueshme). Përveç kësaj, ajo do të ndërmarrë iniciativë në drejtim të çështjeve mjedisore: ruajtjen, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe shfrytëzimin, fushatat e ndërgjegjësimit të publikut për masat e mbrojtjes së mjedisit në përputhje me politikat e BE-së dhe kërkesat e turistëve ekologjikë, veprimet për forcimin e shërbimeve publike përkatëse, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, si dhe rrjetet ndërkufitare, për shembull midis universiteteve, qendrave kërkimore dhe OSHC-ve në fushën e kërkimit dhe edukimit, shkëmbimit të përvojës në tema mjedisore, aktivitetet mësimore mes bashkëmoshatarëve dhe kolegëve homologë, aktivitetet e edukimit joformal, aksioneve vullnetare me fokus të rinjtë etj., iniciativave të sipërmarrjes sociale që mbështesin mbrojtjen e mjedisit (produkte të ricikluara etj.). Më poshtë është dhënë një tabelë përmbledhëse mbi logjikën e ndërhyrjes.

1 - Grupimi tematik 2: Efikasiteti më i gjelbër dhe i përmirësuar i burimeve						
Prioriteti tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut			Treguesit	Baza (viti) 2021	Synimi (viti) 2021	Burimet e të dhënave
Objektivat/rezultatet specifike S	Rezultatet	Llojet e aktiviteteve (shembuj)	<u>Ndikimi</u> Përqindja e popullatës nga zona e programit që përfiton nga ndërhyrjet për mbrojtjen dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe që kontribuojnë në mbrojtjen e ri	0%	20%	Zyrat shtetërore të statistikave

2.1 Bërja e territorit ndërkufitar më të qëndrueshëm në aspektin mjedisor dhe më elastik	2.1.1 Përmirësimi i kapaciteteve për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe menaxhimit	- Investime për të adresuar risqe specifike, duke siguruar qëndrueshmëri ndaj fatkeqësive; - Luftë kundër dëmtuesve të pyjeve dhe tokës bujqësore; - Parandalimi i përmbytjeve, zjarreve, thatësirave, stuhive etj.; - Investime në infrastrukturën dhe sistemet e vogla dhe kritike (p.sh në sistemet e shënjestruara të ujitjes) dhe zgjidhje të tjera praktike; - Koordinimi i reagimit ndaj fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu (duke përfshirë dhe protokollet e përbashkëta të shpëtimit dhe procedurat operacionale, pajisjet për organet publike përgjegjëse); - Rritja e kapaciteteve të shoqatave të qytetarëve, politikëbërësve dhe autoriteteve lokale për nxitjen e qasjeve novatore në menaxhimin mjedisor; - Iniciativa për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në rrezik; - Mbështetja e qasjeve të bazuara në ekosisteme dhe zgjidhjeve me bazë natyrën në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.	Rezultatet - Numri i shërbimeve emergjente nga të dyja anët e kufirit dhe rritja e kapaciteteve të tyre përmes iniciativave ¹⁰ të përbashkëta;	2	8	- Raportet nga përfituesit; - Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR); - Sistemi i monitorimit.
			- Numri i masave të përbashkëta për menaxhimin e riskut në organet e zakonshme të zonës ndërkufitare;	0	5	
			- Numri i strategjive dhe planeve të veprimit të miratuara në bazë të hulumtimit të zonave me rrezik.	1	3	
			Produktet - Numri i personave me kapacitete të rritura në protokollet e shpëtimit (të ndara sipas gjinisë dhe moshës);	0	100	
			- Numri i trajnimeve të zhvilluara;	1	11	
			- Numri i protokolleve të hartuara për ndërhyrje të përbashkëta në zonat kufitare;	0	2	
			- Numri i iniciativave të përbashkëta të zbatuara në lidhje me parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut;	0	2	
			- Numri i shërbimeve të shpëtimit të mbështetura në lidhje me menaxhimin e fatkeqësive.	2	4	

1 - Grupimi tematik 2: Efikasiteti më i gjelbër dhe i përmirësuar i burimeve							
Prioriteti tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut			Treguesit	Baza (viti) 2021	Synimi (viti) 2029	Burimet e të dhënave	
		- Masa për rritjen e elasticitetit në zonat urbane duke promovuar iniciativa të gjelbra (d.m.th. të bazuara tek zgjidhjet natyrale, infrastruktura e gjelbër etj.);	- Numri i departamenteve në administratën publike që janë pajisur për një menaxhim më të mirë ndërkufitar të fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike.	4	8		
		- Zhvillimi i kornizave për bashkëpunimin ndërkufitar dhe për përdorimin bashkërisht të burimeve ekzistuese për mbrojtjen civile dhe për reagimin ndaj fatkeqësive, duke përfshirë edhe risqet e pritshme në të ardhmen (duke përfshirë edhe ato që lidhen me ndryshimet klimatike) që mbështesin parashikimin e rreziqeve të shumfishtë dhe që mbështeten tek studimet dhe udhëzimit e niveleve më të larta.	- Numri i institucioneve të përfshira në iniciativat e përbashkëta të menaxhimit në lidhje me parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut.	4	8		
	2.1.2 Forcimi i mbrojtjes së mjedisit përmes kontrollit të ndotjes dhe forcimit të shërbimeve publike	- Ndarja e mësimeve dhe testimi pilot i zgjidhjeve praktike për marrjen e energjisë së rinovueshme dhe energjisë efikasiteti në ndërmarrje, publike ndërtesat dhe familjet;	Rezultatet - Numri i shërbimeve publike me kapacitete të rritura;	2	4		- Raporte nga përfituesit; - Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR); - Sistemi i monitorimit.
	- Mbështetje për bujqësinë e qëndrueshme	- Përqindja e popullsisë së zonës së programit e arritur nga fushatat ndërgjegjësuere.	Nuk ka të dhëna	30%			
	- (duke u zhvendosur drejtuar të qëndrueshme praktikant në Bujqësia në urdhëroj drejtuar zvogëlojnë ndotjen, edhe nëpërmjet përshtatjes së potencialeve të prodhimit vendor me e jashtme kërkesa, certifikimit të lokal bujqësore produkte, integrimin të lokal prodhuesit në zinxhirin kryesor të furnizimit me të qëndrueshme produkte bujqësore);	Rezultatet - Numri i testeve pilot për marrjen e energjisë së rinovueshme dhe EE;	0	2			
		- Numri i produkteve bujqësore të prodhuara në përputhje me bujqësinë e qëndrueshme;	0	2			

¹⁰ Llojet e iniciativave: Iniciativa duhet kuptuar si një grup aktivitete të dakordësuara dhe të zbatuara në mënyrë të koordinuar për të arritur një rezultat të caktuar. Në shumicën e rasteve, mund të ketë vetëm 1 iniciativë të përbashkët që synon të arrijë të njëjtin rezultat në 1 projekt NBK.

Grupimi tematik 2: Eficienca më e gjelbër dhe më e mirë e burimeve	1. Prioriteti tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	5 355 000	945 000	6 300 000	45.6%
Grupimi tematik 4: Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe konkurrueshmërisë	2. Prioriteti tematik 5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore	5 355 000	945 000	6 300 000	45.6%
3. Asistenca teknike		1 190 000	0.0	1 190 000	8,6%
TOTALI I PLOTË		11 900 000	1 890 000	(e) 13 790 000	100%

Kontributi i Bashkimit Evropian në nivelin e prioritetit tematik nuk do të kalojë kufirin prej 85% të shpenzimeve të pranueshme. Bashkëfinancimi do të sigurohet nga granti përfundimtar. Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të alokuar për programin. Për asistencën teknike, norma e bashkëfinancimit të Bashkimit do të jetë 100%.

²⁸ Totali i përgjithshëm nga tabelat 3 dhe 4 duhet të jetë i barabartë.

5. Marrëveshjet e zbatimit

5.1 Marrëveshja financiare

Për zbatimin e këtij programi, parashikohet të lidhet një marrëveshje financimi ndërmjet Komisionit Evropian, Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë.

5.2 Periudha treguese e zbatimit

Periudha indikative operationale e zbatimit të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 6 vjet nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit, ose nga data në të cilën shkëmbimi i letrave është rënë dakord për të gjitha alokimet e ardhshme vjetore.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të bien dakord nga nëpunësi autorizues përgjegjës i Komisionit duke ndryshuar këtë vendim dhe kontratat, dhe marrëveshjet përkatëse.

5.3 Metodatat e zbatimit

Komisioni do të sigurojë që të respektohen rregullat dhe procedurat e duhura të BE-së për sigurimin e financimit për palët e treta, duke përfshirë procedurat e rishikimit, kur është e përshtatshme, dhe pajtueshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së²⁹.

5.3.1 Operacionet

Menaxhimi indirekt me Malin e Zi

Pjesa operative e këtij veprimi do të zbatohet nën menaxhimin indirekt nga Mali i Zi. Mali i Zi do të presë autoritetin menaxhues dhe organin e ndërmjetëm për menaxhimin financiar. Autoriteti menaxhues do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të programit dhe do të caktojë organet e ndërmjetme.

Në varësi të finalizimit të kuadrit ligjor IPAIII, autoriteti menaxhues përgjegjës për ekzekutimin e veprimit në të gjitha vendet pjesëmarrëse është qeveria e Malit të Zi–Zyra e Integrimit Evropian (EIO). Strukturat BNK, të krijuara sipas kuadrit ligjor IPA III në Mal të Zi dhe në Shqipëri, do të bashkëpunojnë ngushtë në të gjitha detyrat me interes të ndërsjellë, në lidhje me programimin dhe zbatimin e programit.

Detyrat e zbatimit të buxhetit si thirrjet për tenderë, thirrjet për propozime, kontraktimi, menaxhimi i kontratave, pagesat dhe operacionet e të ardhurave, do t'i besohen organit të ndërmjetëm të mëposhtëm për menaxhimin financiar: Ministrisë së Financave dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë për Financa dhe Kontraktime të BE-së, Fondet e Asistencës (CFCU). Ai do të sigurojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve.

Thirrje për Propozime-Grante

a) Qëllimi i granteve:

Grantet e përzgjedhura përmes thirrjeve për propozime gjatë periudhës shtatëvjeçare do të kontribuojnë në objektivat dhe rezultatet specifike, sipas secilit prioritet tematik në seksionin.

b) Lloji i aplikantëve të synuar:

Përfituesit do të jenë persona juridikë, autoritetet vendore, organet publike, OJQ-të, aktorët ekonomikë si NVM-të, organizatat fitimprurëse ose jofitimprurëse.

Aplikantët do të vendosen në një përfitues të IPA III që merr pjesë në programin BNK.

Përfituesit e mundshëm siç specifikohet në seksionin 3.2 mund të jenë: pushtetet vendore dhe institucionet e tyre; agjencitë e zhvillimit; organizatat (përfshirë OSHC-të)/institucionet për mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike; organet publike përgjegjëse për shërbimet e zjarreve/përmbytjeve/emergjencave, institucionet arsimore të të gjitha niveleve; byrotë e qendrave arsimore dhe arsimore profesionale, organizatat turistike në nivel kombëtar/vendor; dhomat e tregtisë; veprat artizanale; shoqatat e biznesit; grupimet; kooperativat; shoqatat e fermerëve; institucionet në fusha të trashëgimisë natyrore/kulturore; bizneset, ndërmarrjet dhe të tjera organizata të përfshirë në arsimim; ofruesit e licencuar të arsimit për të rinjtë dhe të rriturit;

²⁹ www.sanctionsmap.eu Ju lutem vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve buron nga aktet ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare (FZ). Në rast mospërputhjeje ndërmjet akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotëron versioni i OJ.

organizatat rinore.

5.3.2 Asistencë teknike (grante direkte)

Prioriteti i Asistencës Teknike do të zbatohet në Menaxhimin Direkt përmes granteve të drejtpërdrejta gjatë kohëzgjatjes së programit.

Grantet do të jepen për zbatimin e asistencës teknike prioritare tematike në kuadër të këtij programi. Nën përgjegjësinë e nëpunësit autorizues përgjegjës të Komisionit, grantet mund t'i jepen pa thirrje për propozime qeverisë së Malit të Zi – Zyrës së Integritimit Evropian, si partner kryesor, dhe institucionit publik që pret strukturën BNK në Shqipëri si bashkëpërfitues.

Rekursi për dhënien e këtij granti pa thirrje për propozime është i justifikuar për organet me monopol *de jure* ose *de facto* në menaxhimin e këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me nenin 195(c) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046. Siç përcaktohet në seksionin VIII “Dispozitat për programet e bashkëpunimit ndërkufitar”, Titulli V “Strukturat dhe autoritetet e programit dhe përgjegjësitë e tyre” të Marrëveshjes së Partneritetit të Kornizës Financiare për programin IPA III, strukturat e BNK-së janë organet që gëzojnë këtë monopol.

Nën përgjegjësinë e zyrtarit përgjegjës autorizues të Komisionit, granti mund t'i jepet qeverisë së Malit të Zi – Zyrës për Integrim Evropian pa thirrje për propozime.

5.4 Struktura e menaxhimit të programit

Përshkrimi i strukturave të menaxhimit të programit me listën e përgjegjësive dhe detyrave të tyre kryesore në përgatitjen, zbatimin dhe menaxhimin e programit (p.sh. NIPAC, ZKA, Struktura e Menaxhimit, Strukturat BNK, Autoriteti Menaxhues, Autoriteti i Auditimit, Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, KPM, SPT) paraqitet sipas Marrëveshjes Kornizë Financiare të Partneritetit dhe/ose Marrëveshjeve Financiare.

Përveç këtyre Marrëveshjeve, përfituesit do të lidhin, për të gjithë kohëzgjatjen e programit të bashkëpunimit ndërkufitar, një marrëveshje dypalëshe që përcakton përgjegjësitë e tyre përkatëse për zbatimin e programit përkatës të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen e Partneritetit Kornizë Financiare.

5.5 Zhvillimi, përzgjedhja dhe zbatimi i projektit

Për shumicën e ndërhyrjeve, ky program do të zbatohet përmes thirrjeve publike për propozime (CfP) që do të lançohen duke mbuluar një ose më shumë prioritate tematike ose objektiva/rezultate specifike. KPM-ja do të jetë përgjegjëse për identifikimin e prioriteteve tematike, objektivat/rezultatet specifike, rezultatet/rezultatet, përfituesit e synuar dhe fokusin specifik të secilës thirrje për propozime të cilat do të miratohen nga Komisioni Evropian. Autoritetet përgjegjëse në vendet pjesëmarrëse do të sigurojnë transparencë të plotë në proces dhe akses në një gamë të gjerë subjektsh juridike publike dhe jopublike.

Dinamika e publikimit të thirrjeve për propozime varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë logjistikën, kohën e vlerësimit dhe nivelin e interesit nga aplikantët e mundshëm. KPM-ja, si organi që monitoron performancën e programit, do të shqyrtojë, përpara publikimit të thirrjeve për propozime (dhe përcaktimin e dokumenteve të tenderit, p.sh. udhëzimet për aplikantët), ecurinë e treguesve të programit deri në datën. Përzgjedhja e TP-ve, objektivat specifike dhe rezultatet e të gjitha thirrjeve për propozime të ndryshme nga ajo e para sipas programit do të bazohen në atë progres të performancës. Publikimi dhe orientimi strategjik i çdo thirrjeje për propozime do të koordinohet me planet e programeve të tjera për të rritur sinergjitë dhe për të shmangur financimin e dyfishtë.

Vendimet e KPM-së mund të marrin parasysh gjithashtu rekomandimet që rrjedhin nga konsultimet e zhvilluara me palët e interesuara në nivel lokal dhe kombëtar.

Gjatë përgatitjes së programit nuk janë identifikuar projekte strategjike. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të programit mund të konsiderohet të ndahet një pjesë e alokimit financiar të programit (maksimumi 30–35%) për një ose më shumë projekte strategjike, brenda grupit tematik dhe prioriteteve tematike të identifikuar, dhe brenda kufijve të përcaktuara në Kornizën e Programimit. Projektet strategjike mund të zgjidhen përmes thirrjeve për projekte strategjike ose thirrjeve të jashtme për propozime. Në rastin e fundit, partnerët e programit do të identifikojnë së

bashku dhe do të bien dakord për çdo projekt strategjik që do të miratohet nga KPM-ja. Komisioni do të kryejë një vlerësim të rëndësishë dhe maturisë së tyre. Pasi të propozohet dhe miratohet nga KPM-ja dhe të miratohet nga Komisioni, programi BNK duhet të ndryshohet për të përfshirë një projekt të tillë strategjik.

5.6 Fusha e përshtatshmërisë gjeografike për prokurime dhe grante

Përshtatshmëria gjeografike, për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, dhe për sa i përket origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin bazë dhe të përcaktuar në dokumentet përkatëse kontraktuale, do të zbatohet duke iu nënshtuar dispozitave të mëposhtme.

Nëpunësi autorizues përgjegjës i Komisionit mund të zgjasë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve në fjalë, ose në raste të tjera të vërtetuara siç duhet, kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte të pamundur realizimin e këtij veprimi ose tepër të vështirë (neni 28(10) Rregullorja NDICI-*Global Europe*).

6. Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi

Përshkrimi i kërkesave dhe modaliteteve të raportimit, monitorimit dhe vlerësimit të programit është paraqitur nën Marrëveshjen/Marrëveshjen e Partneritetit të Kornizës Financiare.

7. Informacioni dhe vizibiliteti

Vizibiliteti i financimit të BE-së dhe komunikimi në lidhje me objektivat dhe ndikimin e veprimeve janë një detyrim ligjor për të gjitha veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet në kërkesat e BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin në fuqi.

Në veçanti, përfituesit e fondeve të BE-së duhet të njohin origjinën e financimit të BE-së dhe të sigurojnë vizibilitetin e duhur të tij, duke dhënë një deklaratë që thekson mbështetjen e marrë nga BE-ja në mënyrë të dukshme në të gjitha dokumentet dhe materialin komunikues, në lidhje me zbatimin e fondeve, duke i përfshirë në faqen zyrtare të internetit dhe llogaritë e mediave sociale, ku këto ekzistojnë; dhe duke promovuar veprimet dhe rezultatet e tyre, dhe duke ofruar informacion të synuar koherent, efektiv dhe proporcional për audienca të shumta, duke përfshirë edhe median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit do të zbatohen, sipas rastit, nga administrata publike (për shembull, në lidhje me reformat që lidhen me mbështetjen buxhetore të BE-së), subjektet e besuara, kontraktuesit dhe përfituesit e granteve. Detyrimet e duhura kontraktuale do të përfshihen, përkatësisht, në marrëveshjet financuese, marrëveshjet e delegimit dhe kontratat e prokurimit dhe grantit.

Masat do të bazohen në një plan specifik komunikimi dhe vizibiliteti, të krijuar dhe zbatuar në përputhje me kërkesat e BE-së për komunikim dhe vizibilitetin. Planin do të përfshijë, ndër të tjera, një narrativë komunikimi dhe mesazhe për veprimin, të përshtatura për audienca të ndryshme të synuara (aktorët, shoqëria civile, publiku i gjerë etj.).

Masat specifike të vizibilitetit dhe komunikimit për këtë veprim do të jenë plotësuese me aktivitetet më të gjera të komunikimit të zbatuara drejtpërdrejt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacionet e BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacionet e BE-së duhet të jenë plotësisht të informuar për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, veçanërisht në lidhje me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

Dizajni, zbatimi dhe komunikimi dhe vizibiliteti do të jenë përgjegjësi e strukturave BNK. Këto të fundit, me ndihmën edhe të SPT-së, do të prezantojnë një strategji komunikimi me një informacion të detajuar dhe plan vizibiliteti për KPM-në.

8. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e rezultateve dhe e produkteve të ofruara në kuadër të veprimit kërkon një angazhim nga autoritetet kombëtare të përfshira në menaxhimin e programit. Duke respektuar dispozitat e kuadrit ligjor të zbatueshëm për BNK-në ndërmjet Përfituesve të IPA III, autoritetet angazhohen të sigurojnë, sa më shumë që të jetë e mundur, burimet e nevojshme financiare dhe institucionale, duke përfshirë stafin përkatës me përvojë, për ta bërë zbatimin e programit një

histori suksesi. Si shenjë themelore e përgjegjësisë, ata do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë krijimit të kushteve të nevojshme për sigurimin e vazhdimësisë së stafit në funksionet dhe institucionet thelbësore, si një mënyrë për të garantuar mbarrëvajtjen e programit.

Qëndrueshmëria në nivelin e operimit luan po aq një rol vendimtar. Çdo operacion duhet të ketë një ndikim të prekshëm në grupet e tij të synuara në nivel ndërkufitar. Qëndrueshmëria duhet të përfshihet në çdo aplikim, duke treguar se si do të përfitojë rajoni nga rezultatet e pritura edhe pasi operacioni mund të ketë përfunduar. Në çdo thirrje për propozime, një nga kriteret e dhënies është qëndrueshmëria, siç tregohet në seksionin 5 të rrjetit të vlerësimit për aplikimet e plota. Operacionet që nuk mund të demonstrojnë se do të intensifikojnë marrëdhëniet fqinjësore, do të krijojnë partneritete ndërkufitare për zhvillim social, territorial ose ekonomik, dhe/ose heqin pengesat ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm, ka shumë pak gjasa të kenë rezultate të prekshme, efekte shumëfishuese ose ndikim afatgjatë në një perspektivë ndërkufitare, dhe për këtë arsye duhet të përjashtohen nga financimi, pavarësisht nga çdo meritë tjetër.

Marrëveshje Financimi BNK në kuadër të IPA III – Shtojca II – Kushtet e Përgjithshme (v. gusht 2022)

SHTOJCA II KUSHTET E PËRGJITHSHME Tabela e përmbajtjes

Pjesa e parë: Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimit

Neni 2 – Përfituesit e IPA III dhe detyrat e tyre të përbashkëta

Neni 3 – Kërkesat për raportimin

Neni 4 – Komunikimi dhe vizibiliteti

Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 6 – Legjitimiteti i shpenzimeve

Neni 6, germa “a” – Lejet dhe autorizimet

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme për menaxhimin e tërthortë nga përfituesit e IPA

III

Neni 7 – Parimet e përgjithshme

Neni 8 – Prokurimi dhe dhënia e grantit

Neni 8, germa “a” – Përjashtimi dhe sanksionet administrative

Neni 9 – Kontrollat *ex-ante* dhe *ex-post* për procedurat e granteve dhe të prokurimit, dhe kontrollat *ex post* për kontratat dhe grantet që do të zbatohen nga Komisioni

Neni 10 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura

Neni 11 – Dispozitat mbi pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesin kryesor të IPA III

Neni 12 – Ndërprerja e pagesave

Neni 13 – Rikuperimi i fondeve

Neni 13, germa “a” – Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare

Neni 14 – Konsultimi ndërmjet përfituesve të IPA III dhe Komisionit

Neni 15 – Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 16 – Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 17 – Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 18 – Legjislacioni i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 19 – Masat kufizuese të BE-së

PJESA E PARË DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimit

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional, si edhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2, paragrafi 1 të Kushteve të Veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha gjatë së cilës realizohen të gjitha aktivitetet operationale të mbuluara nga kontratat e prokurimit, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e kontributit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2, paragrafi 2 të Kushteve të Veçanta dhe fillon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi për angazhimin buxhetor për vitin e parë ose në datën më të fundit të letërkëmbimit për angazhimet buxhetore për vitet në vijim.

3. Periudha e zbatimit operacional respektohet nga Autoriteti Kontraktor në momentin e nënshkrimit dhe vënies në zbatim të kontratave të prokurimit, kontratave të granteve dhe marrëveshjeve të kontributit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Pa cenuar nenin 29, paragrafi 2 të MFKP-së, kostot e lidhura me aktivitetet e këtij programi të bashkëpunimit ndërkuftar kualifikohen për financim nga BE-ja, vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operacional. Kostot e shkaktuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk kualifikohen për financim nga BE-ja, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 7 të Kushteve të Veçanta.

5. Kontratat e prokurimit, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e kontributit do të lidhen më e shumta brenda tri viteve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit për angazhimin buxhetor për vitin e parë ose në datën më të fundit të letërkëmbimit për angazhimet buxhetore, për vitet në vijim, me përjashtim të:

a) ndryshimeve në angazhimet ligjore të dakordësuara më parë, të cilat nuk çojnë në rritjen e kontributit të BE-së;

b) angazhimeve ligjore që duhet të dakordësohen pas zgjidhjes së parakohshme të një kontrate prokurimi ekzistuese;

c) angazhimeve ligjore që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas periudhës së zbatimit operacional;

d) ndryshimit të subjektit zbatues.

6. Kontrata e prokurimit, kontrata e grantit ose marrëveshja e kontributit që nuk ka çuar në kryerjen e asnjë pagese brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, zgjidhet automatikisht dhe financimi i saj do të kthehet mbrapsht, me përjashtim të rastit kur mosmarrëveshja ka vajtur në gjykatë ose në organet e arbitrazhit.

Neni 2

Përfituesit e IPA III dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76, paragrafi 3 të MFKP-ve përkatëse, përfituesit e IPA III bashkëpunojnë ngushtësisht dhe përmbushin bashkërisht funksionet, si dhe marrin përsipër përgjegjësitë e përcaktuara në MFKP.

2. Për qëllime të zbatimit të nenit 25 të MFKP-së për mbrojtjen e të dhënave, të dhënat personale duhet:

- të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;

- të mblidhen për qëllime të specifikuar, të qarta dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen më tej në mënyrë të papajtueshme me ato qëllime;

- të jenë të duhurat, të kenë lidhje me qëllimin dhe të kufizohen vetëm te qëllimet e nevojshme për të cilat përpunohen;

- të jenë të sakta dhe, sipas rastit, të ruajtura në formë të përditësuar;
- të përpunohen në mënyrë të atillë që garanton sigurinë e përshtatshme të të dhënave personale; dhe
- të ruhen në një formë të atillë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për atë kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale që ndodhen në dokumentet e mbajtura nga përfituesi i IPA III, në përputhje me nenin 8, paragrafi 5, duhet të fshihen menjëherë pas përfundimit të afateve të përcaktuara në nenin 8, paragrafi 5.

Neni 3

Kërkesat për raportimin

1. Për qëllimet e kërkesave për raportimin të përcaktuara në nenin 80, paragrafi 1 të MFKP-ve përkatëse, strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar përdorin modelin e dhënë në shtojcën III.

2. Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuar në nenin 59 të MFKP-së për raportin vjetor mbi zbatimin e asistencës nga IPA III, në cilësinë e përfituesit kryesor të IPA III, KKIPA duhet të përdorë modelin që jepet nga Komisioni.

3. Për qëllimet e nenit 60 të MFKP-së, në cilësinë e përfituesit kryesor të IPA III, KKIPA i dorëzon Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve të zbatuara nën menaxhimin e tërthortë nga përfituesi i IPA III i këtij programi jo më vonë se gjashtëmbëdhjetë muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional. KKIPA duhet të përdorë modelin e dhënë nga Komisioni.

4. Për qëllimet e nenit 61, paragrafi 1 të MFKP-së, në cilësinë e përfituesit kryesor të IPA III, NPA duhet që brenda datës 15 janar të vitit pasues financiar të dorëzojë në format elektronik një kopje të të dhënave që mbahen në sistemin kontabël sipas nenit 4, paragrafi 4. Kjo duhet të mbështetet nga një raport financiar përmbledhës i nënshkruar, i paaudituar, në përputhje me germën “c”, të shtojcës IV.

5. Për qëllimet e kërkesave për raportimin financiar nën menaxhimin e tërthortë të përcaktuara në nenin 61, paragrafi 2, germa “a” dhe nenin 61, paragrafi 3 të MFKP-së, në cilësinë e përfituesit kryesor të IPA III, NPA duhet të përdorë modelet e parashikuara në gerrat “a” dhe “b”, të shtojcës IV.

Neni 4

Komunikimi dhe vizibiliteti

1. Në përputhje me nenin 24 të MFKP-ve përkatëse, përfituesit e IPA III duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar vizibilitetin e financimit nga BE-ja për aktivitetet që u janë deleguar atyre, si dhe të përgatitin një plan koherent me aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti, i cili duhet të dorëzohet pranë Komisionit për dakordësim brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në një linjë me Manualin e Komunikimeve dhe të Vizibilitetit për Aktivitetet e Jashtme të BE-së, i cili është hartuar dhe publikuar nga Komisioni dhe që është në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi garantojnë që përfituesit e IPA III të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale, në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publikimet dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi kryesor i IPA III duhet të garantojë që Komisioni, ose cildo individ apo person tjetër i autorizuar nga Komisioni, si dhe përfituesi jokryesor i IPA III, të kenë akses dhe të drejtën për të përdorur materiale të tilla. Komisioni do t'i përdorë këto materiale vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6

Legjitimiteti i shpenzimeve

1. Në përputhje me nenin 29, paragrafi 3, germa “b” të MFKP-së dhe pa cenuar nenin 28 të saj dhe nenin 7 të Kushteve të Veçanta, shpenzimet vijuese të shkaktuara nga përfituesit e IPA III nuk financohen sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi:

- a) komisionet bankare, kostot e garancive dhe detyrimet e ngjashme;
- b) gjrobat dhe penalitetet financiare;
- c) shpenzimet gjyqësore;
- d) humbjet nga këmbimi valutor;
- e) borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- f) provigjionet për humbjet, borxhet ose detyrimet e ardhshme të mundshme;
- g) kreditimi për palët e treta, përveç nëse specifikohet ndryshe në kushtet e veçanta;
- h) interesi negativ i tarifuar nga bankat ose institucione të tjera financiare.

Neni 6, germa “a”

Lejet dhe autorizimet

Pa cenuar nenin 27 të MFKP-së, çdo leje dhe/ose autorizim që nevojitet për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesve të IPA III, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

PJESA E DYTË

DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR MENAXHIMIN E TËRTHORTË NGA PËRFITUESIT E IPA III

Neni 7

Parimet e përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është që të përcaktojë rregullat për zbatimin e detyrave të deleguara për zbatimin e buxhetit, siç përshkruhen në shtojcën I, dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet përkatëse të përfituesve të IPA III dhe të Komisionit në realizimin e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në germën “b”, të nenit 76, paragrafi 3 të MFKP-ve përkatëse, përfituesit e IPA III duhet të përgatitin bashkërisht një marrëveshje dypalëshe dhe të garantojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi jokryesor i IPA III bashkëpunon me përfituesin kryesor të IPA III për të garantuar përmbushjen e detyrave vijuese:

- a) kryerjen e ndjekjes operacionale dhe menaxhimin e veprimeve të parashikuara në germën “c”, të nenit 76, paragrafi 4 të MFKP-ve;
- b) verifikimet në përputhje me nenin 76, paragrafi 5 të MFKP-ve;
- c) mbrojtjen e interesit financiar të Bashkimit Evropian të parashikuar në nenin 51 të MFKP-ve.

4. Përfituesit e IPA III mbeten përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit (MFKP). Në përputhje me nenin 12, nenin 16, nenin 17 dhe nenin 19, Komisioni rezervon të drejtën të ndërpresë pagesat dhe të pezullojë dhe/ose zgjidhë këtë Marrëveshje Financimi.

Neni 8

Prokurimi dhe dhënia e grantit

1. Pa cenuar nenin 18, paragrafi 5 të MFKP-së, detyrat që përmenden në nenin 7, paragrafi 3 kryhen nga përfituesi kryesor i IPA III në bashkëpunim me përfituesin jokryesor të IPA III në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të hartuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në aktivitetet e jashtme të Komisionit, sidomos, me udhëzuesin praktik për procedurat kontraktuale për aktivitetet e jashtme të Bashkimit Evropian (PRAG), i cili është në fuqi në momentin e nisjes së procedurës në fjalë, si edhe në përputhje me standardet e kërkuara të komunikimit dhe vizibilitetit të përmendura në nenin 4, paragrafi 2.

2. Komisioni, në përputhje me nenin 18, paragrafi 2 të MFKP-ve dhe sipas rastit, mund t'i japë përfituesit kryesor të IPA III udhëzime të mëtejshme, për sa i përket përshtatjes së procedurave dhe dokumenteve standarde të hartuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në aktivitetet e jashtme me rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Përfituesi kryesor i IPA III kryen procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve, lidh kontratat që rrjedhin prej tyre dhe garanton që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmimin e auditimit të jenë në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Përfituesit e IPA III duhet të bashkëpunojnë plotësisht për krijimin e komiteteve të vlerësimit të parashikuara në gjuhën “a”, të nenit 76, paragrafi 4 të MFKP-ve përkatëse.

5. Pa cenuar nenin 49 të MFKP-së, përfituesi kryesor i IPA III duhet që të gjitha dokumentet përkatëse mbështetëse financiare dhe kontraktuale, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme në rast se procedura e prokurimit, thirrja për propozime ose procedura direkte për dhënien e grantit ka nisur përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit, t'i ruajë për pesë vite duke nisur që nga data e mbylljes së angazhimit buxhetor përkatës. Në veçanti, përfituesi kryesor i IPA III duhet të ruajë sa më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit:
 - i. Njoftimin paraprak së bashku me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo korigjim;
 - ii. Caktimin e panelit përzgjedhës;
 - iii. Raportin e listës së të përzgjedhurve (përfshirë shtojcat) dhe aplikimet;
 - iv. Dëshminë e publikimit të njoftimit të listës së të përzgjedhurve;
 - v. Letrat për kandidatët që nuk janë përzgjedhur;
 - vi. Ftesën për ofertë ose të barasvlerëshmen e saj;
 - vii. Dosjen e tenderit duke përfshirë shtojcat, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshminë e publikimit;
 - viii. Caktimin e komitetit të vlerësimit;
 - ix. Raportin për hapjen e tenderit duke përfshirë shtojcat;
 - x. Raportin e vlerësimit/negocimit, duke përfshirë shtojcat dhe ofertat e marra³⁰;
 - xi. Letrën e njoftimit;
 - xii. Letrën përcjellëse për dorëzimin e kontratës;
 - xiii. Letrat për kandidatët e pasuksesshëm;
 - xiv. Njoftimin për shpalljen e fituesit/anulimin, duke përfshirë dëshminë e publikimit;
 - xv. Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondencat përkatëse.
- b) Për thirrjet për propozime dhe procedurat direkte për dhënien e granteve:
 - i. Caktimin e komitetit të vlerësimit;
 - ii. Raportin e hapjes së tenderit dhe atë administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra³¹;

³⁰ Ofertat e pasuksesshme do të asgjësohen pesë vite pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

³¹ Aplikimet e pasuksesshme do të asgjësohen tre vite pas mbylljes së procedurës së grantit.

- iii. Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të prospektit;
- iv. Raportin e vlerësimit të prospektit;
- v. Raportin e vlerësimit të aplikimit të plotë ose raportin e negocimit me shtojcat përkatëse;
- vi. Kontrollin e legjitimitetit dhe dokumentet mbështetëse;
- vii. Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm së bashku me listën e miratuar rezervë pas vlerësimit të plotë të aplikimit;
- viii. Letrën përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;
- ix. Njoftimin për shpalljen e fituesit/anulimin së bashku me dëshminë e publikimit;
- x. Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, klauzolat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Gjithashtu, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 5, germa “a” dhe “b”, të këtij neni do të plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse siç kërkohet nga procedurat e përmendura në paragrafin 1, si dhe me të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe kostot operationale, për shembull raportet e kontrollit të projektit dhe në terren, pranimi i furnizimeve dhe punimeve, garancitë, autorizimet, raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

Neni 8, germa “a”

Përfshirja dhe sanksionet administrative

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde, të hartuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve, përfituesi kryesor i IPA III garanton përkatësisht që asnjë kontratë prokurimi ose granti e financuar nga BE-ja të mos i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grant nëse operatori ekonomik apo aplikanti për grant, qoftë ai vetë apo një person me kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi të, gjendet në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat dhe dokumentet përkatëse standarde të Komisionit.

2. Përfituesi kryesor i IPA III duhet të informojë menjëherë Komisionin në rastin kur një kandidat, ofertues ose aplikant gjendet në një situatë përjashtimi të përmendur në paragrafin 1, ose ka kryer parregullsi dhe mashtrim sipas përcaktimit në nenin 51, paragrafi 5 të MFKP-së, ose ka shfaqur mangësi të theksuara në respektimin e detyrimit kryesor për zbatimin e angazhimit ligjor të financuar nga buxheti i Bashkimit Evropian.

3. Në momentin që jep kontratat e prokurimit dhe të granteve, përfituesi kryesor i IPA III duhet të marrë në konsideratë informacionin që përmban Sistemi i Zbulimit të Hershëm dhe Përjashtimit (SZHP) i Komisionit. Aksesimi në informacion mund të sigurohet nëpërmjet pikave të ndërlidhjes ose përmes konsultimit me anë të mjeteve vijuese: ((Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, Oficeri përgjegjës për Kontabilitetin në Komision, MO15, B-1049 Bruksel, Belgjikë (European Commission, Directorate-General for Budget, Accounting Officer of the Commission, MO15, B-1049 Brussels, Belgium)) dhe nëpërmjet *email*-it në adresën BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu duke vendosur në cc (për dijeni) edhe adresën e Komisionit të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të Veçanta). Çdo kontratë ose grant i lidhur me një kontraktor ose përfitues granti që gjendet në një situatë përjashtimi në momentin e lidhjes së kontratës duhet të përjashtohet nga financimi i Bashkimit Evropian dhe mekanizmi i korrigjimeve financiare mund të vihet në zbatim në përputhje me nenin 13, germa “a”.

4. Kur përfituesi kryesor i IPA III vihet në dijeni të një shtate përjashtimi të përmendur në paragrafin 1 për zbatimin e detyrave të përshkruara në shtojcën I, përfituesi kryesor i IPA III vendos, sipas kushteve të legjislacionit të brendshëm, refuzimin e operatorit ekonomik ose të aplikantit për grant nga procedura në fjalë dhe përjashtimin nga procedurat e tij të ardhshme të prokurimit ose dhënies së grantit. Gjithashtu, përfituesi kryesor i IPA III mund të vendosë një penalitet financiar në përpjesëtim me vlerën e kontratës në fjalë. Refuzimet, përjashtimet dhe/ose

penalitetet financiare duhet të vendosen pas një procesi ankimimi, që garanton të drejtën e personit në fjalë për t'u mbrojtur. Përfituesi kryesor i IPA III njofton Komisionin në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 9

Kontrollet *ex-ante* dhe *ex-post* për procedurat e granteve dhe të prokurimit, dhe kontrollet *ex post* për kontratat dhe grantet që do të zbatohen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* të procedurave për dhënien e prokurimit dhe granteve në fazat vijuese:

- a) miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurimin dhe çdo korigjim të saj;
- b) miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;
- c) miratimin e përbërjes së komiteteve të vlerësimit;
- d) miratimin e raporteve të vlerësimit, të vendimeve për refuzim dhe dhënie të kontratës³²;
- e) miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtojcave në kontratë.

2. Në lidhje me kontrollet *ex-ante* Komisioni vendos:

- a) të kryejë kontrolle *ex-ante* të të gjithë dokumentacionit; ose
- b) të kryejë kontrolle *ex-ante* të një grupi të përzgjedhur nga ky dokumentacion; ose
- c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante* në përputhje me paragrafin 2, germa “a” ose “b”, ai informon përfituesin kryesor të IPA III për dokumentacionin e përzgjedhur për kontrollet *ex-ante*. Ky përfitues i IPA III i paraqet Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm sapo informohet se një dokumentacion është përzgjedhur për kontrollin *ex-ante*, jo më vonë se momenti i dorëzimit për publikim të njoftimit të kontratës ose të udhëzimeve për aplikantët.

4. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post* për procedurat e dhënies së prokurimit ose granteve që nuk i janë nënshtruar kontrollit *ex-ante* (brenda 6 muajve nga nënshkrimi i kontratës).

5. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post*, duke përfshirë auditime dhe kontrolle në terren, kurdoherë dhe për çdo kontratë ose grant të dhënë nga përfituesi kryesor i IPA III që vjen si rezultat i kësaj Marrëveshjeje Financimi. Ky përfitues i IPA III do të vërë në dispozicion të Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, sapo të informohet që një dokumentacion është përzgjedhur për kontrollin *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person ose subjekt që të kryejë kontrolle *ex-post* për llogari të tij.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Struktura e Kontabilitetit dhe Struktura e Ndërmjetme për Menaxhimin Financiar (SNMF) e përfituesit kryesor të IPA III për programin e bashkëpunimit ndërkufitar hap të paktën një llogari bankare në euro për transfertat vjetore. Bilanci i përgjithshëm bankar për programin e bashkëpunimit ndërkufitar do të jetë shuma e bilanceve e të gjitha llogarive bankare të Programit që mbahen nga Struktura e Kontabilitetit dhe të gjitha SNMF-të pjesëmarrëse në përfituesin kryesor të IPA III.

2. Përfituesi kryesor i IPA III duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë Komisionit planet e parashikimit të disbursimit, sipas alokimit vjetor për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të programit, sipas modelit në germën “d”, të shtojcës IV. Këto parashikime duhet të përditësohen dhe të paraqiten me çdo kërkesë për fonde të përmendur në nenin 11, paragrafi 2 dhe nenin 11, paragrafi 3, me raportin financiar vjetor të përmendur në nenin 3, paragrafi 5 dhe me parashikimin

³² Për kontratat e shërbimit, ky hap përfshin kontrollet *ex-ante* lidhur me miratimin e listës së të përzgjedhurve.

për kërkesa për pagesa të mundshme të përmendur në nenin 33, paragrafi 3 të MFKP-së. Planet e parashikimeve të disbursimit duhet të bazohen në nevoja reale dhe aktuale, dhe duhet të mbështeten nga një analizë të hollësishme të dokumentuar (duke përfshirë grafikun e kontraktimeve dhe pagesave të planifikuara për kontratë), që do të vihet në dispozicion të Komisionit, nëse kërkohet.

3. Plan i fillestar për parashikimin e disbursimit duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimeve të disbursimit vjetor, sipas alokimit vjetor për të gjithë periudhën e zbatimit dhe të parashikimit të disbursimit mujor për dymbëdhjetë muajt e parë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Planet e mëvonshme do të përmbajnë një përmbledhje të parashikimeve të disbursimit vjetor, sipas alokimit vjetor për bilancin e periudhës së zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe të parashikimit të disbursimit mujor për katërbëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi kryesor i IPA III duhet të krijojë dhe të mbajë një sistem kontabiliteti, në përputhje me klauzolën 4, paragrafi 3, germa “a”, të shtojcës A të MFKP-së, që do të përmbajë të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar të cilat jepen në shtojcën V.

5. Në zbatim të nenit 57, paragrafi 2 të MFKP-së, kostot e njohura në sistemin e kontabilitetit që mbahen sipas paragrafit 4, duhet të jenë shkaktuar, pranuar dhe paguar dhe të korrespondojnë me shpenzimet aktuale të vërtetuara me anë të dokumenteve mbështetëse dhe, sipas rastit, duhet të përdoren për të likuiduar financimin paraprak të paguar nga përfituesi kryesor i IPA III sipas kontratave në nivel lokal.

Neni 11

Dispozitat mbi pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesin kryesor të IPA III

1. Çdo kërkesë për financim paraprak duhet të përfshijë një deklaratë shpenzimesh për programin, duke përfshirë shumat e kontraktuara, të disbursuara dhe kostot e njohura.

2. Pagesa e parë e financimit paraprak duhet të jetë për 100% të disbursimeve të parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit, për disbursimet në përputhje me nenin 10, paragrafi 2. Kjo kërkesë për financim paraprak duhet të mbështetet nga mandatet bankare për të gjitha llogaritë bankare të programit, sipas rastit.

3. Përfituesi kryesor i IPA III duhet të paraqesë kërkesa pasuese për pagesën e financimit paraprak kur bilanci i përgjithshëm bankar për programin bie nën nivelin e parashikimit të disbursimeve për pesë muajt e ardhshëm të programit.

4. Çdo kërkesë për financim paraprak shtesë duhet të përfshijë:

- a) bilancet bankare për programin në datën e fundit të kërkesës;
- b) mandatet bankare të përditësuara për të gjitha llogaritë bankare të programit, sipas rastit;
- c) një parashikim të disbursimeve për programin për katërbëdhjetë muajt e ardhshëm në datën e fundit të kërkesës, siç përmendet në nenin 10, paragrafi 3;
- d) raportimin në aplikacionin IPA.

5. Përfituesi kryesor i IPA III mundet që për çdo financim paraprak të kërkojë shumën e parashikimit të disbursimeve totale për katërbëdhjetë muajt pas datës së fundit të kërkesës, minus bilancet e përmendura në paragrafin 4, germa “a”, në datën e fundit të kërkesës për fonde, plus çdo shumë të financuar nga përfituesi i IPA III, sipas paragrafit 6 dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme financimi paraprak nëse bilancet e përgjithshme bankare të mbajtura nga përfituesi kryesor i IPA III, në kuadrin e këtij programi, tejkalojnë parashikimin e disbursimit për katërbëdhjetë muajt e ardhshëm.

6. Kur pagesa reduktohet sipas paragrafit 5, përfituesi kryesor i IPA III duhet ta financojë programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi kryesor i IPA III mund të kërkojë më pas rimbursimin e atij financimi si pjesë e kërkesës së radhës për fonde të specifikuar në paragrafin 5.

7. Në përputhje me nenin 33, paragrafi 1 të MFKP-së, Komisioni rezervon të drejtën për të përpunuar pagesa të pjesshme brenda kufijve të fondeve të disponueshme. Pasi fondet të vihen sërish në dispozicion, Komisioni përpunon menjëherë pagesën e shumës së mbetur.

8. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë bilancet e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Përpara ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin kryesor të IPA III të japë arsyet e vonës në disbursimin e fondeve dhe të vërtetojë nevojën e vazhdueshme për to brenda dy muajve të ardhshëm.

9. Interesat e gjeneruara nga llogaritë bankare të përdorura për këtë program nuk do t'i paguhen Komisionit.

10. Sipas nenit 33, paragrafi 4 të MFKP-së, kur Komisioni ndërpret afatin kohor për kërkesën e pagesës për më shumë se dy muaj, përfituesi kryesor i IPA III mund të kërkojë një vendim nga Komisioni lidhur me faktin nëse do të vazhdojë ndërprerja e afatit kohor.

11. Pasqyra përfundimtare e certifikuar e shpenzimeve që përmendet në nenin 36, paragrafi 1, germa “a”, të MFKP-së, duhet të dorëzohet nga NPA-ja jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 12

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi, përkatësisht në përputhje me nenet 16 dhe 17, si dhe pa cenuar nenet 38 dhe 39 të MFKP-së, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze se përfituesi kryesor i IPA III ka kryer gabime të konsiderueshme, parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve të caktuara lidhur me to në zbatimin e programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit, duke përfshirë detyrimet në lidhje me zbatimin e planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit;

b) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze se përfituesi kryesor i IPA III ka kryer gabime ose parregullsi sistematike ose të përsëritura, mashtrime ose shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi apo të tjera si këto, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit, apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA III ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të lidhura me to.

Neni 13

Rikuperimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 40 të MFKP-së, Komisioni mund të rikuperojë fondet nga përfituesi kryesor i IPA III, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) paaftësi për të garantuar arritjen e rezultateve dhe përdorimin e produkteve për qëllimin e synuar të përcaktuar në shtojcën I;

b) shpenzime jolegjitime;

c) shpenzime të shkaktuara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve ose shkeljes së detyrimeve në zbatimin e programit, veçanërisht në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve;

d) dobësi ose mangësi në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të përfituesit të IPA III, që çon në zbatimin e korrigjimit financiar.

2. Në përputhje me legjislacionin e brendshëm, NPA-ja duhet të rikuperojë kontributin e Bashkimit Evropian që i është paguar përfituesit kryesor të IPA III nga marrës që gjendeshin në një nga prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1, gjerat “b” ose “c”, të këtij neni ose të

përmendura në nenin 40 të MFKP-së. Fakti që NPA-ja nuk arrin të rikuperojë të gjitha ose një pjesë të fondeve nuk e pengon Komisionin t'i rikuperojë fondet nga përfituesi kryesor i IPA III.

3. Përfituesi jokryesor i IPA III do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin kryesor të IPA III në përpjekjet e rikuperimit kur marrësi është i vendosur në territorin e tij. Detajet e rikuperimeve parashikohen në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar në përputhje me nenin 70 të MFKP-ve përkatëse.

4. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga përfituesi kryesor i IPA III, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe financimit paraparak të depozituara mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga përfituesi kryesor i IPA III për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktorët ose përfituesit e granteve do të përdoren sërish për programin ose do t'i rikthehen Komisionit.

Neni 13, germa "a"

Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Përveç neneve 42, 43 dhe 47 të MFKP-së, Komisioni ofron udhëzime plotësuese për shqyrtimin dhe pranimin e procedurës së llogarive, duke përfshirë korrigjimet financiare dhe mbylljen.

PJESA E TRETË

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Konsultimi ndërmjet përfituesve të IPA III dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA III dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin përpara marrjes së masave të mëtejshme për ndonjë mosmarrëveshje, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, në zbatim të nenit 18.

2. Në rastet kur Komisioni vihet në dijeni të problemeve në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA III për të rregulluar situatën dhe për të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, pezullim ose zgjidhje të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni vë në dijeni rregullisht përfituesit e IPA III mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në pjesën e dytë të kushteve të përgjithshme.

Neni 15

Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim, përfshirë me anë të letërkëmbimit.

2. Nëse përfituesit e IPA III kërkojnë një ndryshim, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit, të paktën gjashtë muaj përpara se ky ndryshim është planifikuar të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të ndryshojë dokumentet në shtojcat III, IV dhe V pa qenë e nevojshme të ndryshohet kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesit e IPA III informohen me shkrim për çdo ndryshim të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse ndonjë përfitues i IPA III shkel ndonjë detyrim të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi kryesor i IPA III shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në kuadrin e procedurave dhe dokumenteve standarde, të përmendura në nenin 18, paragrafi 2 të MFKP-së, pa cenuar dispozitat e nenit 8, paragrafi 2;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi kryesor i IPA III nuk përmbush kërkesat për delegimin e detyrave për zbatimin e buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesit e IPA III nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në nenin 2, paragrafi 1 dhe, në rastin e menaxhimit të tërthortë, në nenin 7, paragrafi 3;

e) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse ndonjë përfitues i IPA III vendos të pezullojë ose ndërpresë procesin e anëtarësimit në BE;

f) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse ndonjë përfitues i IPA III shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit dhe në rastet e rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi i IPA III është fajtor për shkelje të rëndë profesionale të vërtetuar me çdo mjet të arsyeshëm. Shkelja e rëndë profesionale nënkupton cilëndo nga pikat vijuese:

- shkelje të legjislacionit ose rregulloreve të zbatueshme apo të standardeve etike të profesionit të cilit i përket personi ose subjekti; ose

- çdo sjellje të padrejtë të një personi apo subjekti që ndikon në besueshmërinë e tij profesionale, në rastet kur një sjellje e tillë nënkupton qëllim të padrejtë ose pakujdesi të rëndë;

g) Kjo Marrëveshje Financimi mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. “Forcë madhore” është çdo situatë ose ngjarje e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme, përtej kontrollit të palëve që i pengon ato në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo neglizhence nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktorëve, agjentëve apo punonjësve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme pavarësisht të gjithë kujdesit të duhur të ushtruar. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk mban përgjegjësi për shkelje të detyrimeve të saj nëse pengohet t’i përmbushë ato nga një rast i forcës madhore për të cilin pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një palë që përballlet me forcë madhore duhet të informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si dhe të marrë çdo masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Nëse forca madhore ndikon vetëm në një pjesë të programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm. Asnjëra nga palët nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj, sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë çdo masë të nevojshme paraprake para hyrjes në fuqi të pezullimit.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim apo për kontratat e prokurimit dhe kontratat e granteve që duhet të nënshkruhen, si dhe marrëveshjet e kontributit.

5. Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet pa cenuar ndërprerjen e pagesave dhe zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 12 dhe nenin 17.

6. Palët e përfshira rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit sapo këtë e lejojnë kushtet, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo bëhet pa cenuar ndonjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje Financimi që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhave të zbatimit operacional dhe ekzekutimit, ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 17.

Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila palë mund ta zgjidhë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi 30-ditor.

2. Në rastin kur njoftohet zgjidhja, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim apo për kontratat e prokurimit dhe kontratat e granteve që duhet të nënshkruhen, si dhe marrëveshjet e kontributit.

3. Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk përjashton mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenet 43 dhe 44 të MFKP-së.

Legjislacioni i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i BE-së.

2. Nëse një mosmarrëveshje lidhur me interpretimin, zbatimin ose vlefshmërinë e Marrëveshjes nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo do të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit në përputhje me Rregulloren e Arbitrazhit të vitit 2012 të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (GJPA), duke iu nënshtruar kushteve në vijim:

a) Përbërja e panelit

Për pretendime për shumën 500 000 euro e lart: paneli duhet të përbëhet nga tre arbitra. Çdo palë cakton një arbitër brenda 40 ditëve kalendarike pasi të jetë dërguar njoftimi i arbitrazhit. Dy arbitrat e caktuar nga palët caktojnë nga ana e tyre një arbitër të tretë për të vepruar si arbitër kryesues.

Për pretendime nën 500 000 euro: paneli duhet të përbëhet nga një arbitër, përveç nëse palët bien dakord ndryshe.

Nëse paneli nuk krijohet brenda 80 ditëve kalendarike pasi të dërgohet njoftimi i arbitrazhit, secila palë mund të kërkojë nga Sekretariati i GJPA-së ose autoritet tjetër neutral i pranuar në mënyrë reciproke që të caktojë arbitrat e nevojshëm;

b) Selia

Selia e panelit të arbitrazhit do të jetë Haga, Holandë;

c) Gjuha

Gjuha e procedurave do të jetë anglishtja ose një gjuhë tjetër zyrtare e Bashkimit Evropian e pranuar në mënyrë reciproke. Provat mund të paraqiten në gjuhë të tjera, nëse palët bien dakord;

d) Procedura

Përjashtohet rekursi për masat provizore, ndërhyrjet e palës së tretë dhe ndërhyrjet *amicus curiae*;

Nëse një palë e tretë i kërkon panelit ta trajtojë informacionin ose materialet në mënyrë konfidenciale, vendimi do të merret në formën e një urdhri të arsyetuar dhe pasi të dëgjohej pala tjetër (10 ditë kalendarike për paraqitjen e vërejtjeve). Paneli do të vlerësojë arsyet për kërkesën, natyrën e informacionit dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive. Në veçanti, paneli mund:

- ta bëjë publikimin e informacioneve objekt të detyrimeve specifike; ose

- të vendosë kundër publikimit të informacionit, por të urdhërojë paraqitjen e versionit jokonfidencial ose përmbledhjes së informacionit, ose materialeve, që përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për t'i mundësuar palës tjetër të shprehë pikëpamjet e saj në një mënyrë logjike.

Nëse panelit i kërkohet ta dëgjojë çështjen me dyer të mbyllura, vendimi do të merret pasi të dëgjohej pala tjetër (10 ditë kalendarike për paraqitjen e vërejtjeve).

Paneli merr në konsideratë arsyet për kërkesën dhe kundërshtimet e palës tjetër (nëse ka).

Nëse panelit i kërkohet të interpretojë ose zbatojë legjislacionin e Bashkimit Evropian, ai do të pezullojë procedurat dhe do t'i kërkojë "Kryetarin të Gjykatës së Lartë të Parisit" (*Président du Tribunal de grande instance de Paris, juge d'appui*), në përputhje me nenin 1460 dhe 1505 të Kodit të

Procedurës Civile të Republikës së Francës, të kërkojë marrjen e një vendimi paraprak nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 267 të TFBE-së. Procedurat përpara trupës gjykuese të arbitrazhit rifikojnë pas marrjes së vendimit nga gjykatësi mbështetës (*juge d'appui*). Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë dhe gjykatësit mbështetës është detyrues për panelin.

Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe detyrues për palët dhe duhet të zbatohet prej tyre pa vonesë.

Megjithatë, secila palë mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit nga Gjykata e Apelit e Hagës (*Gerechts Hof Den Haag*) mbi bazën e legjislacionit të brendshëm të zbatueshëm. Në këtë rast, vendimi nuk do të konsiderohet përfundimtar deri në përfundimin e kësaj procedure. Vendimi i gjykatës së rishqyrtimit është detyrues për panelin.

e) Kostot

Kostot e arbitrazhit përbëhen nga:

- tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave;
- kostot e arsyeshme të ekspertëve dhe dëshmitarëve të miratuara nga paneli; dhe
- tarifat dhe shpenzimet e Sekretariatit të GJPA-së për procedurat e arbitrazhit (p.sh. katering, shpenzimet për administratën e gjykatës, sallën, interpretimin).

Tarifat e arbitrave nuk duhet të tejkalojnë:

- 30 000 euro për arbitër nëse shuma e kontestuar është nën 1 000 000 euro;
- 15% të shumës së kontestuar nëse ajo shumë është mbi 1 000 000 euro. Tarifat e arbitrave nuk duhet t'i tejkalojnë në asnjë rast 300 000 euro.

Kostot e arbitrazhit do të paguhën nga palët në mënyrë të barabartë, përveçse kur bien dakord ndryshe.

Palët paguajnë kostot e përfaqësimit të tyre ligjor dhe kostot e tjera të shkaktuara prej tyre në lidhje me arbitrazhin.

f) Privilegjet dhe imunitetet

Marrëveshja për ndjekjen e procedurës së arbitrazhit sipas Rregullores së Arbitrazhit të vitit 2012 të GJPA-së nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga privilegjet ose imunitetet e asnjërës palë, së cilës i takojnë.

Neni 19

Masat kufizuese të BE-së

1. Përkufizime

a) "Masat kufizuese të BE-së" janë masat kufizuese të miratuara në përputhje me Traktatin për Bashkimin Evropian (TBE) ose Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE);

b) "Personi i kufizuar" është çdo subjekt, individ ose grup individësh i përcaktuar nga BE-ja si objekt i masave kufizuese të BE-së³³.

2. Në të gjitha marrëdhëniet e tyre, palët pranojnë se, sipas ligjit të BE-së, asnjë fond apo burim ekonomik i BE-së nuk mund të vihet në dispozicion të personave të kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose për përfitimin e tyre.

3. Përfituesi kryesor i IPA III sigurohet që asnjë transaksion që është objekt i një përputhjeje të verifikuar me listën e sanksioneve të BE-së të mos përfitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga financimi i BE-së. Përfituesi kryesor i IPA III angazhohet ta garantojë këtë detyrim:

a) duke kontrolluar për përputhje me listën e sanksioneve të BE-së, qoftë përpara lidhjes së marrëveshjeve përkatëse apo kryerjes së pagesave në kuadër të tyre, çdo kontraktor, përfitues granti dhe marrës fundor me të cilin përfituesi kryesor i IPA III ka ose pritët të ketë marrëdhënie kontraktuale të drejtpërdrejta (marrësi i drejtpërdrejtë), në mënyrë që të vlerësohet nëse marrësi është një person i kufizuar;

³³ www.sanctionsmap.eu. Harta e sanksioneve është një instrument TI-je për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve rrjedh nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Në rastin e mospërputhjeve ndërmjet akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, përparësi ka versioni i Gazetës Zyrtare.

b) me anë të kontrollit ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme (që mund të përfshijnë një verifikim *ex-post*) mbi bazën e një qasjeje të bazuar në risk, që asnjë subjekt që do të merrte financimin e BE-së në mënyrë të tërthortë të mos jetë person i kufizuar.

4. Në rastin që përfituesi kryesor i IPA III vlerëson se ndonjë nga marrësit (e drejtpërdrejtë apo të tërthortë) i financimit të BE-së është person i kufizuar, përfituesi kryesor i IPA III informon menjëherë Komisionin.

5. Pa cenuar detyrimin në pikën 3 më lart, nëse Komisioni vlerëson se përdorimi i asistencës financiare të Bashkimit Evropian në kuadrin e IPA III rezulton ose ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të BE-së, shumat korresponduese nuk kualifikohen për asistencën financiare të Bashkimit Evropian në kuadrin e IPA III. Kjo nuk cenon asnjë nga të drejtat që Komisioni mund të ketë për të pezulluar ose përfunduar veprimin e ndikuar nga një shkelje e tillë, për të rikuperuar çdo financim të BE-së që është kontribut i Komisionit, ose për ta pezulluar apo zgjidhur këtë marrëveshje financimi.

6. Përcaktimi i masave korrigjuese duhet të bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Masat korrigjuese duhet të zbatohen vetëm për financimin e BE-së që i vihet në dispozicion një marrësi ose për përfitimin e tij, për periudhën gjatë së cilës ka mbetur person i kufizuar.

7. Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet që përmbajnë masat kufizuese të BE-së.

[MODEL]

Raporti vjetor i zbatimit: <Viti>

Bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA III: <Përfituesi X> - <Përfituesi Y>

(Neni XX i Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit)

Tabela e përmbajtjes

Fjalorthi i shkurtimeve

1. Tabela identifikuese
2. Përmbledhje e zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar
 - 2.1 Arritjet dhe analiza e progresit
 - 2.2 Progresi i bërë me zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar
 - 2.2.1 Analiza sasiore
 - 2.2.2 Analiza cilësore
 - 2.3 Informacion i detajuar në lidhje me ekzekutimin në nivel financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar
 - 2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarra nga strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe/ose komiteti i përbashkët i monitorimit për të siguruar cilësinë dhe efikasitetin e zbatimit
 - 2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi
 - 2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese
 - 2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti
 - 2.6 Përdorimi i asistencës teknike
 - 2.7 Ndryshimet në kontekstin e zbatimit të programit ndërkufitar
 - 2.8 Ndërlidhjet plotësuese me instrumente ose politika të tjera sektoriale
 - 2.9 Histori suksesi

Fjalorthi i shkurtimeve

<...>

1. Tabela identifikuese

PROGRAM BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR	Titulli i programit: Program bashkëpunimi ndërkufitar në kuadër të IPA III <shteti A> – <shteti B>
	Fondet e miratuara/shpërndara për periudhën <20XX-20XX>: <shuma duke përfshirë AT>
RAPORTI VJETOR PËR ZBATIMIN	Viti i raportimit: <nga data 1 janar 20XX deri më 31 dhjetor 20XX>
	Përgatitur nga: ▪ <struktura përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkufitar të përfituesit X> ▪ <struktura përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkufitar të përfituesit Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor për zbatimin nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit: <data dhe lloji i procedurës për miratimin e tij, p.sh. në takim ose në formë të shkruar>
	Zona e mbuluar nga programi: <...>

Baza ligjore: (neni 80 i Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit të IPA III)

2. Përmbledhje e zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

2.1 Arritjet dhe analiza e progresit

<Përmbledhje e zbatimit të programit gjatë periudhës së raportimit, që përfshin:

1. Progresin e thirrjeve për propozime:

- Numri i thirrjeve që planifikohen të bëhen deri në fund të periudhës së zbatimit të programit dhe afatet e tyre të mundshme;

- Situata aktuale e thirrjeve të bëra për propozime (numri dhe data e thirrjeve të bëra për propozime, numri dhe data e thirrjeve të mbyllura për propozime, kohëzgjatja e procesit të vlerësimit – hap pas hapi dhe si i tërë);

- Analiza e procesit të vlerësimit (numri i aplikimeve të marra, qoftë të përzgjedhura për financim dhe të refuzuara, sipas prioritetit tematik, objektivit specifik, dhe rezultatit të pritshëm (sipas nevojës); lloji, roli dhe vendi i origjinës së aplikantëve, numri i aplikimeve të refuzuara në çdo fazë të procesit të vlerësimit dhe arsyet më të zakonshme për refuzim (shihni modelin e tabelës nr. XX më poshtë);

- Lista e kontratave të nënshkruara për çdo thirrje për propozim dhe statusi i zbatimit të tyre (shihni modelin e tabelës nr. XX më poshtë);

- Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të vëna në zbatim për aplikantët e mundshëm dhe për përfituesit e granteve (numri i aktiviteteve, numri i pjesëmarrësve sipas llojit të aktivitetit dhe vendit, numri i kërkesave të trajtuara për informacion nga përfituesit e granteve etj.);

- Numri i strukturave të bashkëpunimit ndërkufitar dhe i takimeve të mbajtura mes stafit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik, si dhe rezultatet e dala prej tyre; numri i takimeve të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM) dhe rezultatet e dala prej tyre; numri i takimeve teknike midis strukturave të bashkëpunimit ndërkufitar dhe rezultatet e dala prej tyre.>

2. Progresin me projektet strategjike;

<Sipas rastit, përfshini gjithashtu informacion lidhur me rishikimin e programit për periudhën 2021–2027 ose lidhur me programimin për periudhën 2028–2034.>

Tabela³⁴ nr.: <XX>. Lista e aplikimeve të BNK-së të marra për çdo thirrje për propozime, qoftë të përzgjedhura për financim dhe të refuzuara

Numri i referencës së thirrjes për propozime	Prioriteti tematik	Objekti i specifik dhe rezultati i pritshëm (sipas nevojës)	Titulli	Lloji, roli dhe vendi i origjinës i të gjithë aplikantëve	Shuma e grantit të kërkuar nga BE-ja	Kontroll administrativ (po/jo)	Vlerësim i cilësisë (po/jo)	Përzgjedhur (po/jo)	Arsyeja për refuzim

Tabela³⁵ nr.: <XX>. Lista e kontratave BNK të nënshkruara për çdo thirrje për propozim dhe statusi i zbatimit të tyre

Numri i referencës së thirrjes për propozime: <...>							
Prioriteti tematik: <...>							
Numri i kontratës	Titulli	Emri, lloji dhe vendi i origjinës së koordinatorit dhe i bashkëpërfituesve	Informacion i shkurtër për projektin (objektivat/rezultatet specifike dhe rezultatet/produktet e pritshme)	Data e fillimit dhe e mbarimit	Kostot totale të miratuara dhe vlera e grantit të BE-së	Arritjet kryesore deri më tani	Komente ³⁶

³⁴ Një tabelë për çdo thirrje për propozime.

³⁵ Një tabelë për çdo thirrje për propozime.

³⁶ Në këtë kolonë duhet të përfshihet një referencë për statusin e zbatimit si “përfunduar”, “në vazhdim” ose “për të filluar”.

2.2 Progresi i bërë me zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar

<Prezantim shumë i shkurtër i prioriteteve tematike të programit BNK, objektivave specifike dhe rezultateve të pritshme, së bashku me përshkrimin përmbledhës të progresit të bërë me zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe mbi të gjitha për arritjen e objektivave specifike dhe rezultateve të pritshme për prioritet tematik (duke përfshirë prioritetin e asistencës teknike), si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe ajo cilësore, duke treguar progresin e bërë në raport me synimet.>

2.2.1 Analiza sasiore

<Informacion mbi progresin e bërë me zbatimin e programit ndërkufitar duke e vendosur theksin tek treguesit dhe vlerat e synuara si në nivel projekti ashtu edhe në nivel programi.

Analiza e arritjeve e matur në bazë të produkteve, rezultateve dhe ndikimit, si edhe në formën e treguesve financiarë dhe të procesit. Treguesit duhet të ndahen sipas gjinisë, grupeve të cenuara dhe moshës, kur është e mundur.

Nëse të dhënat e performancës nuk janë akoma të disponueshme, duhet të jepet informacion për kohën se kur ato do të bëhen të disponueshme dhe do të përfshihen në raportin vjetor për zbatimin. Për më tepër, informacioni duhet të paraqitet me anë të grafikëve dhe diagrameve.

Ju lutemi shihni më poshtë një model table treguesish (produkti, rezultati dhe ndikimi) ku jepet një shembull prioriteti tematik i programit, objektivi specifik dhe rezultati.>

Tabela nr.: <XX>. Të dhënat janë agreguar³⁷ në nivel programi, bazuar në informacionin e mbledhur nga projektet

Prioriteti tematik: <...> Objektivi specifik: <...> Rezultati ³⁸ : <...>												
Emri dhe lloji ³⁹	Përkufizimi	Referenca bazë		Arritjet aktuale				Vlera e agreguar deri më 31 dhjetor 202X	Synimi		Burimet e informacionit	Përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave dhe shpeshtësia e mbledhjes së tyre
		Vlera	Viti	Vlera	Viti	Vlera	Viti		Vlera	Viti		
(%) e studentëve (të ndarë sipas gjinisë) të punësuar (treguesi i rezultatit)	(%) e djemve dhe vajzave të reja që mbarojnë arsimin e mesëm dhe gjejnë punë brenda një viti pas përfundimit të studimeve	50%	2021	60%	2023	65%	2027		70%	2029	Statistikat nga Shërbimi Publik i Punësimit	Përfituesit e grantit Çdo tre muaj
.....												
.....												

³⁷ Shumica e të dhënave duhet të nxirren nga sistemi rajonal i monitorimit.

³⁸ Në disa raste, fusha e politikës së sistemit rajonal të monitorimit mund të jetë më e përshtatshme.

³⁹ Çdo tregues duhet të identifikohet si tregues i ndikimit, rezultatit ose produktit.

2.2.2 Analiza cilësore

<Analiza cilësore e progresit (përparimet konceptuale dhe përsosja e ndërhyrjeve) të bërë gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë analizën e ndikimit të programit në zonën e mbuluar nga programi, shoqëruar me shtrirjen gjeografike (përqendrim/shpërndarje harmonike), diferencim të vendbanimeve (rurale/urbane) dhe llojin e përfituesit (autoritete vendore⁴⁰/persona të tjerë juridikë).

Shpjegoni se si programi ka kontribuar ose do të kontribuojë në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm vendor, në rritjen e prosperitetit dhe në ndërtimin e besimit midis komuniteteve, si dhe në avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të mira fqinjësore, po ashtu edhe mënyrën se si mund ta matni apo tregoni këtë.

Përkthyeri mënyrën se si strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe organet e përcaktuara ndërmjetëse regjistrojnë ecurinë e mësimave të nxjerra gjatë periudhës së zbatimit të programit, si për shembull, për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve funksionale të mbledhjes së të dhënave (si për qëllime statistikore ashtu edhe administrative).

Për analizën cilësore, strukturat e programit duhet t'u referohen të dhënave që japin informacion mbi pikëpamjet, opinionet ose konstatimet e njerëzve. Këto të dhëna mbledhen kryesisht nëpërmjet vlerësimeve, gjetjeve nga vizitat e monitorimit, intervistave, takimeve, grupeve të fokusit, sondazheve të opinionit publik, anketave etj. Së fundi, hulumtoni se si çështjet ndërsektoriale (veçanërisht ato që lidhen me politikën e kohezionit: mundësitë e barabarta, barazinë midis burrave dhe grave, zhvillimin e qëndrueshëm dhe luftën kundër diskriminimit) integrohen në hartimin e thirrjeve për propozime dhe në zbatimin e kontratave të grantit.>

2.3 Informacion i detajuar në lidhje me ekzekutimin në nivel financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

<Informacion i detajuar mbi kontraktimin dhe, në kuadrin e menaxhimit të tërthortë, disbursimin (lëvrimin) e fondeve të miratuara vjetore për prioritet tematik dhe për llojin e përfituesit të grantit, duke përfshirë partnerët e projektit (bashkëpërfituesit).

<Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

- Gjendjes financiare;
- Informacionit mbi bashkëfinancimin;
- Faktorëve që penguan dhe/ose vonuan zbatimin financiar;
- Faktorëve që kanë ndikuar pozitivisht në zbatimin financiar.>

Modeli i tabelës për ekzekutimin në nivel financiar të kontratave të BNK-së në zbatim përgjatë periudhës raportuese:

<Tabela nr.: XX>

Prioriteti tematik: <...>						
Numri i kontratës	Emrat, lloji dhe vendet e origjinës së koordinitorit dhe i bashkëpërfituesve	Data e fillimit dhe e mbarimit	Kostot totale të përlogaritura e të miratuara dhe vlera e grantit të BE-së	Vlera kumulative e pagesave	Përqindja e pagesave të ekzekutuara ⁴¹	Komente>

2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarra nga strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe/ose komiteti i përbashkët i monitorimit për të siguruar cilësinë dhe efikasitetin e zbatimit

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

<Masat e monitorimit të marra nga strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar ose komiteti i përbashkët i monitorimit, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave, rishikimin e raporteve të kontratave të grantit, gjetjet dhe ndjekjen e rekomandimeve nga vizitat e monitorimit.

⁴⁰ Ky seksion duhet të përshkruajë gjithashtu gjithçka që strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar apo autoriteti menaxhues ka kryer ose ndërmarrë për të integruar grupin (klasterin) tematik nr. 5 (d.m.th., përf forcimin e kapaciteteve të autoriteteve vendore që marrin pjesë në zbatimin e programit).

⁴¹ [Vlera kumulative e pagesave/vlera e grantit të BE-së] x 100.

Ndërsa për sa i përket programeve të zbatuara nën *menaxhim të tërthortë*, përfshihen përgatitja, ekzekutimi, gjetjet, rekomandimet dhe ndjekja e masave të vlerësimit të ndërmarra nga autoriteti menaxhues (shihni nenin 56 të MFKP-së).

Në programet e zbatuara nën *menaxhim të drejtpërdrejtë*, përfshihen mbështetja, gjetjet, rekomandimet dhe ndjekja e masave të vlerësimit të ndërmarra nga Komisioni.>

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

<Përmbledhje e problemeve thelbësore të hasura gjatë zbatimit të programit dhe me garantimin e qëndrueshmërisë, si edhe veprimet korrigjuese të ndërmarra dhe rekomandimet për veprime të mëtejshme.

Rekomandimet për veprime korrigjuese (të mëtejshme).>

Kur programi zbatohet nën menaxhim të tërthortë, duhet të nxirren në pah edhe problemet e mundshme në menaxhimin e programit, siç mund të jenë problemet thelbësore të hasura gjatë zbatimit të detyrave që janë deleguar, p.sh. vonesa në kontraktim, si dhe masat e marra/të planifikuara në vijimësi.

2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti

<Masat e ndërmarra për të siguruar vizibilitetin dhe publicitetin e programit (d.m.th. plani i komunikimit dhe vizibilitetit, shihni nenin 76 të MFKP-së), duke përfshirë artikujt promocionalë, monitorimin e pranisë në shtyp, reklamimin në median e gjerë, shembujt e praktikave më të mira, nxjerrjen në pah të ngjarjeve të rëndësishme si: seminarët, konferencat, tryezat e rrumbullakëta, forumet, Dita Evropiane e Bashkëpunimit, Java Evropiane e Rajoneve dhe Qyteteve dhe panairët e projektit; mirëmbajtja e bazës së të dhënave të aplikantëve të mundshëm, e faqes së internetit të programit, e faqeve të mediave sociale etj.>

2.6 Përdorimi i asistencës teknike

<Shpjegim i detajuar i përdorimit të asistencës teknike dhe i çdo problemi të qenësishëm të hasur me zbatimin e buxhetit të AT-së. Së fundmi, duhet të prezantohet analiza e treguesve të produkteve, rezultateve dhe ndikimeve të Kontratës së Grantit për Asistencë Teknike (KGAT), në një mënyrë të ngjashme si në seksionin e mësipërm 2.2.1.>

2.7 Ndryshimet në kontekstin e zbatimit të programit ndërkufitar

<Sipas rastit, përshkrimi i çdo elementi që, edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga asistenca e programit, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e programit (p.sh. ndryshimet ligjore, ndryshimet përkatëse socio-ekonomike etj.).>

2.8 Ndërlidhjet plotësuese me instrumente ose politika të tjera sektoriale

<Një përmbledhje e koordinimit dhe koherencës aktuale të programit me programe të tjera të IPA-s, programe të bashkëpunimit ndërkombëtar, programe ose iniciativa kombëtare dhe të shteteve anëtare të BE-së të cilat mund të aksesohen në zonën e mbuluar nga programi. Koordinimi dhe koherenca e programit me politika të tjera të Komunitetit Evropian dhe mbi të gjitha me strategjitë makro-rajonale të BE-së. Ndërlidhja plotësuese me instrumente të tjera financiare, asistencën ndërkombëtare dhe/ose politikat rajonale të BE-së (p.sh.: Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, Axhenda e Gjellbër e Ballkanit Perëndimor dhe Axhenda e Ballkanit Perëndimor për Inovacionin, Kërkimin shkencor, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin).>

2.9 Histori suksesi

<Përshkruani, sipas rezultateve të arritura, të paktën një shembull (preferohet të jenë dy) të veprimtarive të BNK-së periudha e zbatimit të të cilave ka përfunduar gjatë periudhës së raportimit dhe që sipas parametrave të mëposhtëm mund të konsiderohen histori suksesi:

- Dimension i qenësishëm i BNK-së (ju lutemi tregoni se cili përkufizim i BNK-së është përdorur për të vlerësuar propozimet e projektit, siç tregohet në udhëzimet përkatëse për aplikantët: a) “*zbatimi në bashkëpunim i aktiviteteve nga partnerët, të cilat çojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare dhe/ose në heqjen e pengesave ndërkufitare drejt një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik*”; ose b) zbatimi në bashkëpunim i aktiviteteve nga partnerët

të cilat çojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare *dhe/ose në heqjen e pengesave ndërkufitare drejt një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik*”).

- Ndikim i qenësishëm i BNK-së: fqinjësi më e mirë dhe përfitim për njerëzit nga të dyja anët e kufirit në një mënyrë të atillë që projekti në nivel kombëtar nuk do ta kishte arritur.

- Risiprurës: për sa i përket fushës, partnerëve të përfshirë ose aktiviteteve dhe metodave të zbatuara.

- Efikas: Rezultatet janë arritur në kohë dhe në përputhje me buxhetin e planifikuar.

- Shpërndarje e mirë: vizibilitet, replikim, shumëfishim dhe efekt domino.

- Perspektivë e mirë për qëndrueshmëri: përfitime të mundshme edhe përtej kohëzgjatjes së projektit dhe partneritet afatgjatë.>

<Historitë duhet të kenë strukturën e mëposhtme:

Fjali që tërheqin vëmendjen, të cilat përmbledhin suksesin e projektit

Kontekst

Përshkrim të problemit specifik që është trajtuar

Idenë pas projektit

Zgjidhjen e propozuar

Tre shembuj të aktiviteteve të ndërmarra

Fakte që vërtetojnë suksesin

Vizionin

Burimet ku mund të gjendet më shumë informacion (p.sh. faqe interneti)

Të dhënat e kontaktit të partnerëve të BNK-së>

[illegible]

(**) Raportul financiar për periudhën 12 mujore duhet dorëzuar deri në datën 31 korrik me të dhëna ku mblatjeve deri në datën 30 qershor.

Unë, i nënshtreskruar _____, NPA për perfuruesin e IPA III _____ deklaroj se raport/deklarata financiare e mesipërme është e plotë, e saktë dhe e vertetë në përputhje me nenin 61, paragrafi 5 të MPKP-së.

Raporti financiar vjetor i përfituesit të IPA III (*)

[illegible]

Unë, i nënshkruari _____, NPA për përfituesin e IPA III _____, deklaroj se raporti/deklarata financiare e mësipërme është e plotë, e saktë dhe e vërtetë në përputhje me nenin 61, paragrafi 5 të MFKP-së.

Raporti vjetor në mbyllje të periudhës kontabël të vitit ushtrimor i përfituesit të IPA III (*)

[illegible]

Unë, i nënshkruari _____, NPA për përfituesin e IPA III _____, deklaroj se raporti/deklarata financiare e mësipërme është e plotë, e saktë dhe e vërtetë në përputhje me nenin 61, paragrafi 5 të MFKP-së

*Ky model do të përdoret edhe për programet IPA I dhe IPA II

Shtojca IV(d) - plani i parashikimit të disbursimit sipas nenit 4, paragrafi 2 të i

Të dhënat që prej:
Plan i parashikimit të disbursimit për përfituesin e IPA III

Referenca e programit	Numri i referencës OPSYS i Marrëveshjes së Financimit	Plani i parashikimit të disbursimit (shtori vitet sipas nevojës)																	
		Parashikimi i disbursimit mujor (për RfF: 12 muaj për kërkesën e parë për financim paraprak/ 14 muaj për financimin paraprak vijues; për raportin financiar vjetor dhe parashikimin e kërkesave për pagesa të mundshme: 24 muaj)																	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Totali për 12 muaj	13	14	Totali për 14 muaj*	15-24	Totali për 24 muaj**
PVV 2021	JAD.XXXXXX																		
BNK AA/BB (alokimi për 2024)																			
PSHVV për mjedisin																			

* Kolonat O deri në Q të përdoren për financimin paraprak vijues
** Kolonat O deri në S të përdoren për raportin financiar vjetor dhe parashikimin e kërkesave për pagesa të mundshme

Shtojca IV(e) - parashikimi i kërkesave për pagesa të mundshme sipas nenit 33, paragrafi 3 të MFKP-së
Të dhënat që prej:
Parashikimi i kërkesave për pagesa të mundshme për përfituesin e IPA III

Numri i referencës OPSYS ose ekuivalenti i Marrëveshjes së Financimit	Referenca e programit	Hyrja në fuqi e MF-së	Afati i kontraktimit	Afati i zbatimit operacional	Alokimi i buxhetit në nivel lokal në euro*	Fondet e BE-së të paguara nga KE në euro	RAL në datën 31.12.21 në euro	RfF-të në BE në euro	Parashikimi total 202X-202Y	Parashikimi për 202X (sipas muajve)												Parashikimi për 202Y						
										Totali për 202X	01-202X	02-202X	03-202X	04-202X	05-202X	06-202X	07-202X	08-202X	09-202X	10-202X	11-202X	12-202X	Totali 202Y	T1/202Y	T2/202Y	T3/202Y	T4/202Y	
1	2	3	4	5	6	7	8=6-7																					
	PK 2012																											
Totali i Programeve IPA-I																												
	2016 PVV - Obj. 1/Obj. 2: (MTVP)																											
	BNK 2016 AA-BB																											
	PSHVV për mjedisin																											
Totali i Programeve IPA II																												
	2021 PVV (MTVP)																											
Totali i Programeve IPA III																												
Totali i programeve IPA I, IPA II dhe IPA III																												

* ABNL përkon me kontributin total të BE-së për MTVP-në deri në afatin e kontraktimit; pas afatit të kontraktimit përkon me totalin e kontraktuar.

Të dhënat kryesore

Për çdo kontratë në nivel lokal kërkohet ky informacion:

1. Vendimi i BE-së

Referenca e programit, p.sh. Programi Vjetor i Veprimit 2022

2. Kontrata e BE-së

Numri i referencës OPSYS i Marrëveshjes së Financimit, p.sh. 2014/031-878

3. Titulli

Titulli i kontratës në nivel lokal

4. Referenca e kontratës në nivel lokal

5. Kontraktori/forma e subjektit juridik (FSJ)

6. Lloji i kontratës

P.sh. Granti, shërbimi, furnizimi, punimesh, binjakëzimi,...

7. Data e nënshkrimit të kontratës

Data kur kontrata nënshkruhet nga pala e fundit.

8. Data e fillimit të zbatimit të kontratës

Data e nënshkrimit për kontraktorin, data e nënshkrimit për autoritetin kontraktor, data në të cilën kontrata hyn në fuqi dhe data në të cilën fillon zbatimi i kontratës janë koncepte të ndryshme, të cilat mund të jenë të gjitha në të njëjtën ditë ose në ditë të ndryshme.

Më konkretisht, data e fillimit të zbatimit të kontratës (= ditën e parë kur nisin kostot legjitime sipas kontratës) mund të vendoset pasi të jetë nënshkruar kontrata përmes një klauzole përkatëse në kontratë, një urdhri administrativ, etj. Sistemi juaj mund t'i regjistrojë të gjitha këto data; por për qëllimet e raportit vjetor të periudhës kontabël data më e rëndësishme është data e fillimit të zbatimit.

9. Data e përfundimit të zbatimit të kontratës

Rregulluar në bazë të amendimeve të saj, sipas nevojës. Kjo zakonisht nuk është e njëjtë me datën përfundimtare të realizimit, ku përfshihet koha e faturimit, periudhat e garancisë, etj.

Data e përfundimit të zbatimit të kontratës është data e fundit në të cilën mund të shkaktohen kosto legjitime sipas kontratës. Kontrata mund të lejojë kohë shtesë për finalizimin e administrimit të kontratës ose një periudhë midis pranimit të përkohshëm dhe përfundimtar të punës së kryer; por kjo kohë shtesë nuk vlen për raportin përfundimtar të fundvitit.

10. Statusi i kontratës

HAPUR, MBYLLUR, ZGJIDHUR, PA FILLUAR (nëse data e fillimit të aktiviteteve është pas datës së raportit përfundimtar të fundvitit)

11. IPA BE - Vlera fillestare e kontratës

Shuma fillestare ligjore e zotuar nga ana e IPA-s (financimi i BE-së).

12. IPA BE - Vlera aktuale e kontratës

Shuma pas amendimeve (sipas rastit)

Vlera aktuale e kontratës do të përfshijë çdo ndryshim të shumave të kontraktuara të bërë përmes një shtojce që modifikon kontratën.

13. IPA BE - Shuma e paguar

Shuma totale e paguar sipas kontratës; p.sh. pagesat e financimit paraprak + shuma e faturave të paguara në mënyrë të drejtpërdrejtë - rikuperimet).

14. Detyrime të prapambetura (RAL)

"Reste à liquider" është "detyrimi i prapambetur".

Shuma e zotuar, por që nuk i është paguar ende përfituesve dhe kontraktorëve nga fondet e IPA BE.

15. IPA BE - Rikuperimet

Vlera totale e rikuperimeve (si rikuperimet e financimeve paraprake dhe rikuperimet e shpenzimeve) të bëra sipas kontratës (sipas rastit).

Zakonisht rikuperimet do të jenë nga financimet paraprake. Rikuperimet e financimeve paraprake janë tërësisht transferata në para cash, të cilat nuk kanë asnjë ndikim në koston totale. Me raste, rikuperimet do të bëhen për pagesa shpenzimesh, të cilat janë pranuar si legjitime në fillim, por më pas janë refuzuar në bazë të informacioneve të reja. Rikuperimet e shpenzimeve do të zvogëlojnë koston totale të raportuar në kontratë (ju lutemi shihni pikën 19.).

16. IPA BE - Financimi paraprak i paguar

Vlera totale e financimit paraprak të paguar sipas kontratës (sipas rastit).

Financimi paraprak është një pagesë e cila ka për qëllim t'i sigurojë përfituesit një "jastëk" financiar, d.m.th. një paradhënie në para cash. Si i tillë, ai paguhet përpara lëvrimin të mallrave dhe shërbimeve (në rastin e kontratave të prokurimit) dhe përpara se përfituesi të nisë me koston e miratuara (në rastin e marrëveshjeve të grantit). Financimi paraprak njihet në bilanc në momentin kur bëhet transferimi i parasë cash të marrësi.

17. IPA BE - Financimi paraprak i rakorduar

Vlera totale e financimit paraprak të rakorduar.

Pagesa e financimit paraprak njihet si aset. Në përputhje me rregullin përkatës të kontabilitetit, aset i financimit paraprak përgjithësisht nuk njihet më (pra, rakordohet/reduktobet) në rastet si më poshtë:

- nëse shuma e një fature të përkohshme/përfundimtare ose pretendimi kostoje, ose një pjesë e saj, justifikon përdorimin e financimit paraprak, atëherë validimi i këtyre shpenzimeve legjitime do të çojë në rakordim të financimit paraprak;

- nëse përfituesi nuk e përdor financimin paraprak (një pjesë të tij), atëherë shuma e financimit paraprak do të rikuperohet pjesërisht ose plotësisht nga përfituesi.

18. IPA BE - Financimi paraprak i hapur

Vlerat totale nga 16 dhe 17 do të japin totalin e financimit paraprak të hapur (të parakorduar) të paguar në kuadër të programit, pra financimi paraprak i paguar – financimi paraprak i rakorduar.

19. IPA BE - Kosto e njohur

Kostot totale të shkaktuara, pranuar, paguara (pagesa direkte e kostove plus rakordimi i financimit paraprak sipas kontratës) dhe të faktuara me dokumente mbështetëse.

Llogaritja bëhet me anë të formulës së mëposhtme: 19 = 12 (IPA BE - Vlera aktuale e kontratës) - 14 (RAL) - 18 (IPA BE - Financimi paraprak i hapur) - 15 (IPA BE - Rikuperimet). Ju lutemi përfshini në llogaritjen e "IPA BE - Kosto e njohur" vetëm rikuperime të shpenzimeve duke zbritur koston e njohur (+19 bis (IPA BE - kosto e shkaktuar dhe e pranuar por ende e papaguar) - VETËM nëse nuk mundeni të shtoni në raport një kolonë të veçantë 19 bis).

Kostot do të përfaqësojnë vlerën e legjitime të punës që është:

Ø shkaktuar sipas kontratës, pranuar, paguar nga autoriteti kontraktor (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet financimit paraprak të rakorduar) dhe është faktuar me anë të dokumenteve mbështetëse,

Ø shkaktuar dhe paguar nga kontraktori (sipas rastit - për shembull, nënkontraktorëve ose nga përfituesit e grantit) dhe pranuar dhe paguar nga autoriteti kontraktor; në rastin e kostove të përkohshme, pranimi përfundimtar cilësohet se varet nga rezultati final i kontratës.

Vini re se:

** Kostot e konstatuara (vlera e përlllogaritur e punës së bërë, por që është ende e pafaturuar) nuk kërkohen.*

** Për qëllime të këtij raporti, shumat e zotuar por të papaguara nuk janë kosto.*

** Financimi paraprak i paguar nga autoriteti kontraktor ose nga kontraktori (sipas rastit) nuk është kosto.*

19 bis. IPA BE - Kosto e shkaktuar dhe e pranuar, por ende e papaguar

Shembuj të tillë janë:

- faturat në fluksin e punës që janë vërtetuar të sakta (të shkaktuara dhe të pranuar), por që do të paguheshin vetëm në periudhën vijuese të raportimit; ose

- garancitë.

Ju lutemi, kini parasysh: Nëse ju, p.sh. për arsye teknike - nuk mund ta shtoni këtë kolonë në raportin tuaj, ju lutemi shtojni shumat përkatëse posaçërisht direkt në kolonën 19 dhe tregoni arsyen e përfshirjes së tyre duke

specifikuar se: 'Kolona 19 përfshin kostot e shkaktuara, të pranuara, por ende të papaguara, në shumën prej (...)', për këtë arsye: '(...)' ose na vini në dijeni me anë të një shkrese në formë shtojce për shumat përkatëse sipas kontratës.

Ju lutemi të keni parasysh gjithashtu se shumat e vendosura në këtë kolonë konsiderohen si kosto të shkaktuara dhe të pranuara vetëm për qëllime të raportit përfundimtar për këtë fundvit dhe jo për qëllime të raportit financiar vjetor ose të kërkesës për fonde, ku duhet të merren në konsideratë vetëm kostot e njohura (të shkaktuara, pranuara, paguara dhe të faktuara me dokumente mbështetëse).

Rastet kur kostot raportohen me faturë (zakonisht prokurimet)

20. Kosto në fluksin e punës - Shuma e faturës (para vlerësimit të shumës legjitime)

Faturat dhe raportet janë marrë, por ende nuk janë miratuar.

Rastet kur nuk ka faturë dhe kostot identifikohen nga një raport financiar (zakonisht grantet)

20. Kosto në fluksin e punës - Shuma e raportit financiar (para vlerësimit të shumës legjitime)

Raportet janë marrë, por ende nuk janë miratuar.

MARRËVESHJE FINANCIMI BNK, NË KUADËR TË IPA III – SHTOJCA IV RAPORTI FINANCIAR (V. KORRIK 2022)

MARRËVESHJE FINANCIMI BNK, NË KUADËR TË IPA III - SHTOJCA V SPECIFIKIMET MINIMALE TË SISTEMIT TË KONTABILITETIT ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA (V. KORRIK 2022)

Shtojca V e Marrëveshjes së Financimit **Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të** **konstatuara**

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit të IPA III duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të pasqyrojë strukturën organizative që është krijuar për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatur me realizimin e detyrave. Më konkretisht, përpara autorizimit të një operacioni, të gjithë aspektet (si operacionale dhe financiare) e operacionit duhet të verifikohen nga anëtarë të stafit krahas atyre që janë përgjegjës për nisjen e operacionit. Personi që do të merret me verifikimin nuk mund të jetë në varësi të atij që e ka filluar transaksionin.

2. Të përfshijë një gjurmim të auditimit për të gjitha transaksionet dhe amendimet.

3. Të ketë siguri fizike dhe elektronike të përshtatshme, duke përfshirë sistemet mbështetëse dhe ato të rikuperimit.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të ruajë të paktën informacionin e mëposhtëm për kontratat në nivel lokal nën menaxhimin e secilit program:

- a) Numrin e referencës së kontratës;
- b) Vlerën e kontratës duke përfshirë çdo amendim;
- c) Datat e nënshkrimit të kontratës (për të dyja palët);
- d) Datën e fillimit të zbatimit të kontratës,

Kjo është krahas datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të ndryshojë prej saj, pasi data e fillimit të punimeve të kontratës jepet përmes një urdhri administrativ pas nënshkrimit të kontratës;

e) Datën e përfundimit të zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo amendim,

Kjo është data e fundit në të cilën mund të shkaktohen kosto legjitime. Ajo nuk përfshin asnjë periudhë garancie ose kohë në dispozicion për përgatitjen e raportit nga kontraktori;

f) Totalin e paguar (kesh) sipas kontratës;

g) Financimin paraprak të paguar sipas kontratës,

Njohja shprehimisht dhe regjistrimi në bilanc i financimit paraprak të kërkuar sipas kontratës;

h) Koston e njohur - të drejtpërdrejtë (sipas kontratës),

Njohja shprehimisht e kostos si shpenzim për vitin fiskal. Disa pagesa do të bëjnë mbulim të drejtpërdrejtë të kostove që janë shkaktuar tashmë. Nuk ka asnjë financim paraprak të përfshirë. Ato mund të jenë pagesa përfundimtare ku tashmë është rakorduar çdo financim paraprak ose pagesa të ndërmjetme ku është rakorduar financimi paraprak, ose në rastet kur kontrata nuk përfshin dispozitën e financimit paraprak,

i) Koston e njohur - të tërthortë (sipas kontratës);

Njohja shprehimisht e kostos si shpenzim për vitin fiskal. Disa fatura apo pretendime kostosh të cilat janë dorëzuar nga përfituesi i grantit apo kontraktori, do të lidhen me kosto të cilat mbulohen nga financimi paraprak i paguar më herët gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes ose kontratës së grantit. Në këto raste, pagesa e bërë do të jetë më e vogël se kosto që është raportuar. Mund të jetë edhe zero nëse të gjitha kostot janë mbuluar nga financimi paraprak. (me siguri do të jetë zero nëse kostot e raportuara nuk mjaftojnë për të përthithur financimin paraprak dhe nëse është lëshuar një urdhër rikuperimi për bilancin e papërdorur nga financimi paraprak). Në të gjitha këto raste sistemi duhet të regjistrojë si shpenzim vlerën e plotë të kostos legjitime të raportuar për vitin fiskal dhe të zbresë nga bilanci i financimit paraprak shumën e kostove që janë kompensuar nga financimi paraprak, në momentin që përcakton shumën që duhet të paguhet.

j) Urdhrat e rikuperimit për të zbritur financimin paraprak (sipas kontratës);

Njohja e zbritjes së financimit paraprak në bilanc, pas rikuperimit të financimit paraprak që nuk është përdorur;

k) Urdhrat e rikuperimit për të zbritur koston (sipas kontratës),

Kur bëhet rikuperim kundrejt kostove që janë pranuar më parë - me gjasa pas një hetimi për mashtrim. Në të tilla raste kostot e regjistruara për atë vit duhet të zbriten në rast se kostot janë pranuar në po të njëjtin vit kur ka ndodhur rikuperimi; ose regjistrohen të ardhurat (hyrjet) në rastin kur kostot janë pranuar një vit përpara atij kur ka ndodhur rikuperimi;

l) Datën e faturës së furnizuesit për çdo faturë ose dokument tjetër të shoqëruar nga një raport financiar që reflekton kostot e njohura;

m) Informacion kontekstual rreth rikuperimit për kostot jolegjitime dhe rikuperimet.